

ZBATIMI I KURRIKULËS PËR FËMIJËT ME AFTËSI TË KUFIZUARA NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR

Në ndihmë të mësuesve ndihmës
2024



Leave
No One
Behind



Ky publikim u realizua në kuadër të projektit “Edukimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsimin parauniversitar”, iniciuar nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar, ASCAP dhe mundësuar nga bashkëpunimi me UNDP, përmes Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara “Askush të mos mbetet pas/Leave No One Behind” LNB, që mbështetet nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC)

Grupi i ekspertëve që mbështeti dhe punoi për përgatitjen e guidës:

Erida Koleci dhe Albana Markja (Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar/ASCAP); Ingrid Trajani (Eksperte e pedagogjisë speciale); Silvana Agastra, Erisa Vidrica, Brunilda Zyka, Rozana Bana dhe Rajmoda Mollaymeri (Mësuese ndihmëse në arsimin parauniversitar)

Punimi grafik:

Esion Zgjana (Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar/ASCAP)

© Copyright 2020.

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për ASCAP, Tiranë, Shqipëri. Përmbajtja e këtij dokumenti mund të përdoret apo kopjohet lirisht prej mësuesve dhe specialistëve për zhvillim politikash dhe praktikash, por jo për qëllime fitimprurëse, me kusht që çdo riprodhim të shoqërohet me njohjen e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar si burim.

TABELA PËRMBAJTJES

TABELA PËRMBAJTJES	3
I. HYRJE	4
II. PLANIFIKIMI I MËSIMDHËNIES PËR NXËNËSIT ME AFTËSI TË KUFIZUARA BAZUAR NË KURRIKULËN ZYRTARE	5
Planifikimi i mësimdhënies dhe rëndësia e tij	5
Planifikimi i mësimdhënies për nxënësit me aftësi të kufizuara	6
Pse është i rëndësishëm planifikimi i mësimdhënies për nxënësit me aftësi të kufizuara?	7
Kudri ligjor për planifikimin e mësimdhënies për nxënësit me aftësi të kufizuara	7
Udhëzime të përgjithshme për planifikimin e mësimdhënies për nxënësit me aftësi të kufizuara	15
Planifikimi i mësimdhënies me programe lëndore të zakonshme ose të përshtatura për nxënësit me aftësi të kufizuara	17
Plani Edukativ Individual	22
Struktura e planit ditor për mësuesin ndihmës	30
III. ZBATIMI I KURRIKULËS ZYRTARE PËR FËMIJËT ME AFTËSI TË KUFIZUARA	32
Përshkrim i detajuar i lëndës Gjuhë shqipe	35
Përshkrim i detajuar i lëndës Matematikë	44
IV. BASHKËPUNIMI MES MËSUESVE TË ARSIMIT TË PËRGJITHSHËM DHE ATYRE TË PEDAGOGJISË SPECIALE	56
Çfarë është mësimdhënia bashkëpunuese?	56
Planifikimi për bashkëpunim efektiv	57
Formimi i mësuesve dhe zhvillimi profesional	59
V. MODELE VEPRIMTARISH MËSIMORE NË LËNDË TË NDRYSHME	60

I. HYRJE

Praktikat gjithëpërfshirëse në fushën e arsimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara në vendin tonë janë produkt i zhvillimit të procesit të arsimit special për këta fëmijë, ndër vite, duke ruajtur dhe trashëguar tiparet më të mira, duke përqafuar përvojat pozitive të shoqërive europiane, si dhe duke u influencuar e ndikuar fuqishëm nga eksperiencat kombëtare. Si gjithë arsimi parauniversitar, edhe arsimi gjithëpërfshirës ka historinë e vet të zhvillimit dhe të rritjes në vetvete, në lidhje me legjislacionin, menaxhimin organizativ dhe zhvillimin e përmbajtjes shkollore apo kurrikulës.

Zbatimi i një kurrikule zyrtare për fëmijët me aftësi të kufizuara është një sfidë e qenësishme dhe një detyrë e rëndësishme në arsimin parauniversitar. Ky proces kërkon përgatitje dhe angazhim të veçantë për të siguruar që çdo fëmijë të ketë mundësinë e një arsimi të përshtatshëm dhe të cilësisë së lartë. Përballë këtyre detyrave, institucionet arsimore kanë reflektuar, duke krijuar mundësi që të gjithë fëmijët të arsimohen në bazë të veçorive dhe kapaciteteve të tyre.

Në arsimit tonë parauniversitar, mbështetja e edukimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara udhëhiqet nga besimi se fëmijët me aftësi të kufizuara kanë kapacitete dhe aftësi që mund të çojnë drejt asimilimit të programit mësimor brenda mundësive të tyre.

Guida “Zbatimi i kurrikulës për fëmijët me aftësi të kufizuara në arsimin parauniversitar” vjen si material burimor që synon të vijë në ndihmë mësuesve ndihmës, duke ofruar metodologji dhe praktika që përdoren për të përshtatur, zbërthyer dhe zbatuar kurrikulën zyrtare për të përmirësuar qasjen dhe mësimin për fëmijët me aftësi të kufizuara. Ajo tenton të mbështesë procesin e zhvillimit profesional të mësuesve ndihmës për fëmijët me aftësi të kufizuara me synim aftësimin e tyre në zbatimin e kurrikulës në mënyrë që arsimit të mund të bëhet një mjet i fuqishëm për përmirësimin e jetës dhe përparimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara.

II. PLANIFIKIMI I MËSIMDHËNIES PËR NXËNËSIT ME AFTËSI TË KUFIZUARA BAZUAR NË KURRIKULËN ZYRTARE

Planifikimi i mësimdhënies dhe rëndësia e tij


Termi “planifikim i mësimdhënies” nënkupton procesin e përgatitjes dhe të organizimit të aktiviteteve mësimore nga mësuesi për të përmbushur rezultatet e pritshme. Ky proces përfshin hartimin e një plani të strukturuar dhe të organizuar në të cilin përcaktohet se si do të zhvillohet procesi mësimor për një periudhë të caktuar kohore, si p.sh., një vit shkollor, një periudhë, një orë mësimi. Baza e një planifikimi të suksesshëm është njohja e mirë e programit mësimor; mësuesi duhet të zbatojë me përpikmëri të gjitha kërkesat e tij.

Planifikimi ka disa elemente kryesore:

- Qëllimet ose rezultatet e të nxënit, të cilat përcaktohen nga mësuesi për të treguar se çfarë ai dëshiron që nxënësit të arrijnë gjatë procesit mësimor. Qëllimet ose rezultatet lidhen me njohuritë, aftësitë, sjelljet dhe zhvillimin e përgjithshëm të nxënësve. Rezultatet e të nxënit të përcaktuara në programet mësimore të secilës lëndë dhe klasë janë një themel i përbashkët për të gjithë mësuesit. Mësuesit përzgjedhin vetë metodat dhe strategjitë më të përshtatshme, burimet e mundshme për t'u shfrytëzuar, llojet dhe mjetet e vlerësimit në lidhje me përmbushjen e tyre.
- Materialet mësimore të cilat përzgjidhen nga mësuesi si mjete ose burime për të mbështetur mësimin. Këto mund të përfshijnë tekste shkollore, përmbajtje mësimore digjitale, programe kompjuterike, fletë pune, mjete didaktike etj.
- Strukturimi i orës së mësimi, i cili përfshin organizimin e përmbajtjes së mësimi, ndarjen e kohës mësimore në pjesë/ etapa/ faza të ndryshme. Përmbajtja mund të ndahet në seanca mësimore, aktivitete ose punë në grup, diskutime, punë e pavarur, vlerësime etj.
- Përshtatja dhe puna e diferencuar, të cilat nënkuptojnë që mësuesi e planifikon mësimin duke marrë në konsideratë nevojat dhe nivelin e aftësive të nxënësve. Përshtatja dhe diferencimi janë të rëndësishme për të siguruar që të gjithë nxënësit të kenë mundësi të barabarta për të mësuar.
- Metodatat, teknikat dhe strategjitë mësimore, të cilat përdoren nga mësuesi për të përmbushur rezultatet e të nxënit.

- Vlerësimi, i cili përfshin përcaktimin e metodave ose të teknikave të vlerësimit për të gjykuar se në çfarë mase kanë arritur nxënësit rezultatet e përcaktuara më parë, në funksion të përmirësimit të këtyre rezultateve dhe nxitjes së progresit të nxënësit.
- TIK: planifikimi i mësimdhënies përfshin edhe përdorimin e teknologjisë për të përmirësuar procesin e të nxënës.

Planifikimi i mësimdhënies është i rëndësishëm pasi i jep siguri mësuesit, është një hartë e qartë për mësimdhënien dhe e bën mësuesin një model pozitiv për nxënësit.



Planifikimi i mësimdhënies për nxënësit me aftësi të kufizuara

Mësimdhënia me nxënësit me aftësi të kufizuara kërkon një përkujdesje të veçantë dhe përshtatje në procesin mësimor për të adresuar nevojat dhe sfidat e këtyre nxënësve. Kjo përfshin planifikimin e mësimin duke marrë në konsideratë individualitetin e secilit nxënës, duke përdorur metoda dhe strategji të diferencuara, si dhe duke përshtatur materialet mësimore për të përmirësuar qasjen e tyre në mësim. Mësuesit duhet të jenë ndërgjegjshëm për diversitetin e aftësive dhe duhet të përdorin një gamë të gjerë strategjish, duke përfshirë teknologjinë dhe mjete të tjera ndihmëse, për të siguruar një mjedis të nxëni gjithëpërfshirës dhe mbështetës. Bashkëpunimi me prindërit, specialistët e fushës dhe ekspertët e tjerë është gjithashtu i rëndësishëm për të përmirësuar procesin e të nxënës dhe për të siguruar zhvillim të suksesshëm për nxënësit me aftësi të kufizuara.

Pse është i rëndësishëm planifikimi i mësimdhënies për nxënësit me aftësi të kufizuara?

Planifikimi i mësimdhënies për të gjithë nxënësit është i rëndësishëm, por kur bëhet fjalë për nxënës me aftësi të kufizuara, ky proces është një sfidë e veçantë dhe kërkon më shumë përkushtim, pasi çdo nxënës ka nevojë për një qasje të individualizuar. Disa nga arsyet pse planifikimi i mësimdhënies për nxënësit me aftësi të kufizuara është i rëndësishëm, janë:

- I jep mundësi mësuesit të planifikojë krijimin e një mjedisi të nxëni gjithëpërfshirës, ku të gjithë nxënësit ndihen të përfshirë dhe të vlerësuar.
- Nxënësit me aftësi të kufizuara shpesh kanë nevoja të veçanta dhe përshtatje të tjera në mësimdhënie për të zhvilluar aftësitë e tyre. Planifikimi i jep mundësi mësuesit të mendojë dhe të vendosë për strategjitë dhe materialet mësimore që përshtaten me nevojat e tyre.
- Nxënësit me aftësi të kufizuara shpesh mund të hasin sfida në ndërveprimin social. Planifikimi i jep mundësi mësuesit që të përcaktojë strategji që inkurajojnë bashkëveprimin dhe sigurojnë një mjedis mbështetës.
- Teknologjia dhe mjetet e tjera ndihmëse mund të jenë shumë efikase për nxënësit me aftësi të kufizuara. Planifikimi i mësimdhënies mund të përfshijë identifikimin dhe përdorimin e këtyre burimeve për të ndihmuar në mësimin dhe zhvillimin e këtyre nxënësve.
- Planifikimi krijon mundësi që mësuesit dhe stafi ndihmës (psikolog, logoped, terapist etj.) të bashkëpunojnë për të ndarë rolet dhe detyrat për të krijuar një plan efikas dhe për të siguruar mbështetje optimale për nxënësin.

Kuadri ligjor për planifikimin e mësimdhënies për nxënësit me aftësi të kufizuara

Në **ligjin nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”**, i ndryshuar në lidhje me planifikimin e mësimdhënies për nxënësit me aftësi të kufizuara përcaktohet:

Neni 45 “Dokumentacioni kurrikular”

- Ministri, pas konsultimit me Këshillin Kombëtar të Arsimit Parauniversitar, miraton:
 - a) kornizën kurrikulare;
 - b) planin mësimor për çdo nivel arsimor,
 - c) nivelet e arriçjeve;

- 
- 
- d) programet lëndore, përveç atyre që hartohen nga institucioni arsimor.
- Kurrikula, që hartohet në nivel institucioni arsimor, miratohet nga drejtori i tij pas marrjes së pëlqimit nga njësia arsimore vendore.

Neni 63 “Parime të arsimimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara”

- Arsimimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara synon zhvillimin e plotë të potencialit intelektual e fizik dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së tyre për t'i përgatitur për integrim të plotë në shoqëri dhe në tregun e punës.
- Përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara në institucionet arsimore të specializuara për ta është përgjithësisht e përkohshme. Përfshirja dhe integrimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara në kopshtet dhe shkollat e zakonshme të arsimit bazë është parësore.
- Nxënësve, që nuk dëgjojnë e nuk flasin, u garantohet e drejta e komunikimit në gjuhën e shenjave, ndërsa atyre që nuk shikojnë, përdorimi i shkrimit Brail.

Neni 65 “Organizimi i arsimimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara”

- Nxënësit me aftësi të kufizuara mësojnë sipas planit mësimor e programeve lëndore të zakonshme, të përshtatura për ta, ose sipas planit mësimor e programeve lëndore të specializuara për ta.
- Në institucionet arsimore të zakonshme, programi i personalizuar për nxënësin me aftësi të kufizuara hartohet nga një komision, në përbërje të të cilit janë mësues të fushave të ndryshme të të nxënës të institucionit e psikologë. Hartimi i këtij programi bëhet në bashkëpunim me prindërit e nxënësit. Ndryshimi i programit të personalizuar brenda një institucioni arsimor vendoset nga komisioni brenda institucionit, në bashkëpunim me prindërit e fëmijës.
- Njësia përkatëse bazë e qeverisjes vendore u siguron nxënësve me aftësi të kufizuara mjediset e përshtatshme të mësimdhënies e të të nxënës, sipas standardeve të përcaktuara nga ministria.

Në **Rregulloren për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë**, në lidhje me planifikimin e mësimdhënies përcaktohet:

Neni 80

Ngritja e komisionit në ZVA dhe detyra të tij

- Komisioni:
 - a) njofton personin që ushtron përgjegjësinë prindërore për gjendjen dhe ecurinë e fëmijës;
 - b) i jep me shkrim personit që ka paraqitur kërkesën, rekomandimin për ndjekjen nga fëmija të shkollës së zakonshme ose të specializuar, ose kalimin nga shkolla e specializuar në shkollën e zakonshme apo anasjelltas;
 - c) rekomandon shërbimet shtesë që duhet të marrë fëmija në qendra ditore ose në institucione të tjera të specializuara për shërbimet rehabilituese;
 - d) rekomandon pajisjen e fëmijës me raportin mjeko-ligjor kur fëmija nuk e ka.
- Komisioni njofton me shkrim drejtorin e institucionit të zakonshëm arsimor se cilët nga fëmijët me AK do të mësojnë me plan mësimor dhe programe lëndore të zakonshme, të përshtatura ose individuale, si dhe rekomandon mjetet ndihmëse që i nevojiten fëmijës për të realizuar procesin mësimor-edukativ.

Neni 81

Detyra të Zyrës Vendore Arsimore

- ZVA-ja siguron:
 - a) arsimimin e fëmijëve me AK në një IA publik të zakonshëm ose të specializuar;
 - b) arsimimin në shtëpi të nxënësve me AK që nuk mundën të ndjekin shkollë të zakonshme ose të specializuar të arsimit bazë.
- ZVA-ja pajis me përparësi nxënësit me AK me mjete mësimore dhe pajisje ndihmëse për mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe zhvillimin e tyre personal e ndërpersonal.

- ZVA-ja organizon, nëpërmjet NjShPS-së së saj, bashkëpunimin e mësuesve të shkollave të specializuara me mësuesit e shkollave të zakonshme, për hartimin dhe vënien në jetë të planeve edukative individuale (PEI) për nxënësit me AK.

Neni 83

Komisioni i institucionit arsimor të zakonshëm

- Drejtori i IA-së së zakonshme ngre komisionin për nxënësit me AK, në përbërje të të cilit janë tre mësues të lëndëve të fushave të ndryshme të të nxënës dhe psikologu/punonjësi social. Në komision merr pjesë të paktën një nga mësuesit e nxënësit me AK dhe mësuesi ndihmës (kur ka). Kryetar i komisionit është punonjësi i shërbimit psiko-social.
- Komisioni i IA-së së zakonshme, bazuar në vlerësimin e komisionit të ZVA-së:
 - a) udhëzon mësuesit për hartimin e PEI-ve dhe i miraton ato;
 - b) ndihmon mësuesit gjatë zbatimit të PEI-ve;
 - c) ndjek ecurinë e fëmijëve me AK;
 - ç) paraqet në komisionin e ZVA-së raportin e ecurisë së nxënësit me AK, sipas formatit të vendosur nga komisioni i ZVA-së.

Neni 84

Ndjekja e shkollës. Vlerësimi i nxënësve me AK.

Dokumente të përfundimit të shkollimit

- Vlerësimi i nxënësve me AK është si i nxënësve të tjerë. Nxënësit me AK me PEI vlerësohen në përputhje me objektivat e vendosur në PEI-në përkatës.
- Nxënësi me AK, pas përfundimit të çdo klase, pajiset me dëftesë që përmban një rubrikë ku përshkruhen përmbledhtas objektivat kryesorë të PEI-së së tij.

Neni 85

Nxënësit që nuk dëgjojnë ose/dhe nuk flasin ose/dhe nuk shikojnë

- Nxënësve që nuk dëgjojnë e nuk flasin, u garantohet e drejta e arsimimit në gjuhën e shenjave, ndërsa atyre që nuk shikojnë përdorimi i shkrimit *Brail*.
- Materialet mësimore ndihmëse janë në formatin e përshtatshëm (në *Brail*, tekste me shkronja të mëdha etj.). Kur është e nevojshme, përdoren versione të thjeshtuara të tekstit të lëndës mësimore.
- Kurrikula e nxënësve që nuk shikojnë apo nuk flasin ose/dhe nuk dëgjojnë, është përgjithësisht kurrikula e zakonshme.
- Me rekomandimin e Komisionit Multidisiplinar të ZVA-së, nxënësve u sigurohen edhe tekste për mësimin e gjuhës së folur dhe komunikimin global.

Neni 86

Shkollat e specializuara për nxënësit me aftësi të kufizuar

- Mësuesit e shkollave të specializuara janë të diplomuar në arsimin special.
- Shkollat e specializuara kanë punonjës të specializuar në aftësinë e kufizuar, që ofrojnë shërbime mbështetëse të specializuara (mjekë, punonjës të shërbimit psiko-social, terapistë), si dhe mësues ndihmës.
- Nxënësit që, sipas gjykimit të komisionit të vlerësimit në ZVA, kanë nevojë për trajtim të individualizuar, punojnë me PEI.
- Shkollat e specializuara, nën organizimin e ZVA-së, shërbejnë si qendër shkëmbimi përvojë për mësuesit e IA-ve të zakonshme që punojnë me fëmijë me AK.

Neni 10

Planifikimi i mësimdhënies në arsimin bazë

- Planifikimi i mësimdhënies në arsimin bazë përfshin: planifikimin lëndor vjetor të ndarë në tri periudha, planifikimin për secilën periudhë dhe planifikimin ditor.

- Në fillim të vitit shkollor, mësuesi dorëzon në drejtorinë e shkollës planin vjetor të lëndës, i cili është një kornizë e ndarjes së përgjithshme të përmbajtjes lëndore dhe të orëve mësimore, si edhe planin e periudhës së parë. Planet e periudhës së dytë dhe të tretë dorëzohen para fillimit të secilës periudhë.
- Gjatë vitit, sipas rrethanave që i krijohen, mësuesi mund të bëjë ndryshime në planin fillestar të periudhës, ndryshime të cilat miratohen nga drejtori i IA-së.

Neni 60

Plani lëndor i mësuesit. Aspekte të zbatimit të tij

- Pesë ditë-pune para fillimit të vitit shkollor, mësuesi dorëzon planin lëndor te drejtori i IA-së, si dhe planin lëndor të periudhës së parë.
- Mësuesi harton planin lëndor sipas Kornizës Kurrikulare, programit përkatës të lëndës ose fushës së të nxënës, pikëpamjeve të tij pedagogjike dhe në përshtatje me nxënësit e tij.
- Gjatë vitit mësimor, kur krijohen rrethana të reja, mësuesi mund të bëjë ndryshime në planin lëndor. Çdo ndryshim miratohet nga drejtori i shkollës dhe pasqyrohet në planin e dorëzuar në drejtori.
- Plani lëndor i mësuesit shqyrtohet në ekipin lëndor përkatës dhe merr trajtën përfundimtare pas këtij shqyrtimi.

Neni 61

Plani ditor (ditari) i mësuesit

- Mësuesi harton rregullisht planin (ditarin) e çdo ore të mësimit. Ai planifikon situata të nxënë, në të cilat nxënësit ndërveprojnë për zhvillimin e kompetencave kyç dhe të kompetencave të lëndës.
- Ditari përmban rubrika në përputhje me udhëzuesit kurrikularë.
- Për klasat paralele, ditari mund të përmbajë ose jo vetëm veçoritë e zhvillimit në ato klasa, nëse ka të tilla.
- Ditari është objekt monitorimi dhe vlerësimi.
- Mësuesi e ruan ditarin për një vit shkollor.

Në udhëzimin nr. 11, datë 26.06.2023 “Për një shtesë në udhëzimin nr. 17, datë 05.07.2022 “Për vlerësimin e nxënësve në sistemin arsimor parauniversitar”, i ndryshuar përcaktohet se:

Vlerësimi i nxënësve në Institutin e Nxënësve që Nuk Dëgjojnë

1. Në të gjitha lëndët e tjera mësimore dhe modulet profesionale, përveç lëndëve speciale, vlerësimi i nxënësve realizohet në përputhje me përcaktimet në udhëzimin nr. 17, datë 05.07.2022, të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit “Për vlerësimin e nxënësve në sistemin arsimor parauniversitar”.
2. Për lëndën e gjuhës shqipe dhe për lëndën e gjuhës angleze, në klasat 1-3 hiqet kompetenca e të dëgjuarit.
3. Për lëndët speciale, në klasat 1-3, vlerësimi bëhet për lëndë dhe në kolonën e kompetencave vihet vetëm emërtimi i lëndës. Në klasat 4-9, vlerësimi në lëndët speciale realizohet në përputhje me udhëzimin nr. 17, datë 05.07.2022, të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit “Për vlerësimin e nxënësve në sistemin arsimor parauniversitar”.

Vlerësimi i nxënësve në Institutin e Nxënësve që Nuk Shikojnë

1. Për lëndët speciale, në klasat 1-3, vlerësimi bëhet për lëndë dhe në kolonën e kompetencave vihet vetëm emërtimi i lëndës. Në klasat 4-9, vlerësimi në lëndët speciale realizohet në përputhje me udhëzimin nr. 17, datë 05.07.2022, të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit “Për vlerësimin e nxënësve në sistemin arsimor parauniversitar”.
2. Në të gjitha lëndët e tjera mësimore, vlerësimi i nxënësve realizohet sipas skemës së përcaktuar në udhëzimin nr. 17, datë 05.07.2022, të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit “Për vlerësimin e nxënësve në sistemin arsimor parauniversitar”.

Vlerësimi i nxënësve në shkollat speciale

1. Në përfundim të çdo periudhe, në çdo lëndë mësimore, nxënësit vlerësohen me fjalë dhe shprehje në klasat 1-3, dhe me një notë në klasat 4-9. Ky vlerësim është rezultat i të gjitha vlerësimeve / notave që nxënësi ka marrë gjatë periudhës në lëndën përkatëse.
2. Numri i notave në çdo lëndë mësimore për një periudhë është sipas udhëzimit nr. 17, datë 05.07.2022, të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit “Për vlerësimin e nxënësve në sistemin arsimor parauniversitar”.
3. Vlerësimi përfundimtar vjetor (nota vjetore) në çdo lëndë mësimore është rezultat i tri vlerësimeve/notave të periudhave.

4. Për përcaktimin e vlerësimit të periudhave dhe vlerësimit përfundimtar mësuesi duhet të marrë në konsideratë progresin e nxënësve.
5. Dokumentimi në regjistër i rezultateve të vlerësimit për lëndët mësimore sipas periudhave në shkollat speciale është si më poshtë:

Periudha e parë	Periudha e dytë	Periudha e tretë	Përfundimtare
- Vlerësim me fjalë e shprehje në klasat 1-3. - Vlerësim me notë në klasat 4-9.	- Vlerësim me fjalë e shprehje në klasat 1-3. - Vlerësim me notë në klasat 4-9.	- Vlerësim me fjalë e shprehje në klasat 1-3. - Vlerësim me notë në klasat 4-9.	- Vlerësim me fjalë e shprehje në klasat 1-3. - Vlerësim me notë në klasat 4-9.

Udhëzime të përgjithshme për planifikimin e mësimdhënies për nxënësit me aftësi të kufizuara

Më poshtë janë sugjeruar disa udhëzime të përgjithshme për planifikimin e mësimdhënies për nxënësit me aftësi të kufizuara. Planifikoni të:

- Ndërttoni njohuri dhe aftësi mbi njohuritë dhe aftësitë e mëparshme të nxënësve.
 - ✓ Identifikoni dhe kuptoni nevojat dhe aftësitë individuale të secilit nxënës me aftësi të kufizuara.
 - ✓ Përdorni informacionin e disponueshëm nga ekspertët dhe specialistët në fushën e aftësive të kufizuara.
- Përdorni një qasje të diferencuar.
 - ✓ Përshtatni materialin mësimor dhe përdorni metoda të ndryshme.
 - ✓ Sigurohuni që materialet dhe mësimet të jenë të përshtatshme për nivelin e tyre të njohurive, aftësive dhe zhvillimit.
- Krijoni një mjedis mbështetës të nxëni ose zhvillimi.
 - ✓ Sigurohuni që mjedisi i klasës të jetë i përshtatshëm për të gjithë nxënësit, duke përfshirë strukturën fizike të klasës dhe organizimin e kohës mësimore.
 - ✓ Inkurajoni bashkëveprimin dhe i ndihmoni nxënësit të ndihen pjesë e grupit.
 - ✓ Kujdesuni për nevojat emocionale të nxënësve, përfshirë ndjesitë e përfshirjes, sigurisë dhe vetëvlerësimit.
 - ✓ Krijoni një mjedis mbështetës dhe inkurajues për të ndihmuar nxënësit të ndihen rehat dhe të motivuar.
- Përdorni teknologjinë dhe mjetet e tjera ndihmëse.
 - ✓ Përcaktoni mjetet/pajisjet digjitale ose softuerët që mund të ndihmojnë në lehtësimin e mësimin për nxënësit me aftësi të kufizuara.
- Përcaktoni qëllime/ rezultate të arritshme dhe të matshme, si dhe vlerësime të përshtatshme.
 - ✓ Formuloni rezultate/objektiva të përshtatshëm për çdo nxënës, duke marrë parasysh aftësitë e tyre.

- ✓ Përcaktoni teknika vlerësimi që lejojnë të vlerësohet progresi dhe arritjet individuale.
- Komunikoni me prindërit, kolegët, ekspertët ose stafin ndihmës.
- ✓ Mbani komunikim të vazhdueshëm me prindërit dhe specialistët për të pasur një kuptim më të mirë të nevojave të nxënësve.
- ✓ Kërkoni këshilla dhe përkrahje për të zhvilluar strategji mësimore efektive.
- Jepni udhëzime të qarta dhe të thjeshta.
- ✓ Përdorni udhëzime të qarta dhe të thjeshta për të ndihmuar nxënësit të kuptojnë dhe ndjekin veprimtaritë mësimore.
- ✓ Përdorni gjuhë të thjeshtuar dhe të qartë për të komunikuar me nxënësit dhe për t'i bërë materialet më të qasshme.
- Përdorni materiale multimediale dhe vizuale.
- ✓ Përdorni materiale vizuale dhe multimediale për të përmirësuar kuptimin dhe përfshirjen e nxënësve.
- ✓ Sigurohuni që materialet të përfshijnë shpjegime dhe udhëzime të thjeshta dhe të qarta.
- Përdorni stimulime multisensoriale.
- ✓ Përfshini stimulime të shumta sensoriale për të mbështetur mësimin, duke përdorur të gjitha shqisat.
- Mbështetni bashkëpunimin mes nxënësve.
- ✓ Inkurajoni bashkëpunimin dhe ndihmën ndërmjet nxënësve për të përmirësuar ndjenjën e përfshirjes dhe për të zhvilluar aftësi sociale.
- Monitoroni shëndetin dhe mirëqenien e nxënësve.
- ✓ Monitoroni shëndetin dhe mirëqenien e përgjithshme të nxënësve, duke plotësuar rregullisht nevojat e tyre dhe duke bërë ndryshime sipas tyre.
- ✓ Identifikoni nevojat dhe sigurohuni që të keni planifikuar veprimtari për përmirësime të mundshme në mësim.

- Vlerësoni dhe jepni informacion (feed-back) konstruktiv.
- ✓ Sigurohuni që vlerësimi dhe feedback-u të jenë konstruktiv dhe të përshtatshëm për nivelin dhe nevojat e çdo nxënësi. Inkurajoni përmirësimin dhe zhvillimin e tyre të vazhdueshëm.

Planifikimi i mësimdhënies me programe lëndore të zakonshme ose të përshtatura për nxënësit me aftësi të kufizuara

Duke u bazuar në *nenin 65* të ligjit për arsimin parauniversitar “Organizimi i arsimimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara” ku theksohet se nxënësit me aftësi të kufizuara mësojnë sipas planit mësimor e programeve lëndore të zakonshme, të përshtatura për ta, ose sipas planit mësimor e programeve lëndore të specializuara për ta.

Për nxënësit me aftësi të kufizuara si p.sh., nxënësit që nuk dëgjojnë, nxënësit me aftësi të kufizuara fizike, të cilët mund të punojnë programe lëndore të zakonshme ose të përshtatura për ta, procesi i planifikimit realizohet njësoj si për nxënësit e tjerë.

Për një planifikim të mirë, mësuesi duhet të njohë dokumentet e mëposhtme:

- Kornizën kurrikulare
- Kurrikulën bërthamë
- Programin mësimor

Baza e një planifikimi të suksesshëm është njohja e mirë e programit mësimor. Mësuesi duhet të zbatojë të gjitha kërkesat e këtij programi. Rezultatet e të nxënit janë një themel i përbashkët për të gjithë mësuesit. Ata përzgjedhin vetë metodat dhe strategjitë më të përshtatshme, burimet e mundshme për t’u shfrytëzuar, llojet dhe mjetet e vlerësimit.

Llojet e planifikimeve

Planifikimi i mësimdhënies përfshin:

- Planifikimin vjetor
- Planifikimin për secilën periudhë
- Planifikimin ditor

Në fillim të vitit shkollor mësuesi duhet të dorëzojë pranë drejtorisë së shkollës *planin vjetor* të lëndës, i cili shërben si një kornizë e ndarjes së përgjithshme të përmbajtjes lëndore dhe të orëve mësimore, si edhe *planin e periudhës së parë* (shtator- dhjetor). Planet e periudhës së dytë dhe të tretë dorëzohen para fillimit të secilës periudhë.

Gjatë vitit, sipas rrethanave që i krijohen, mësuesi mund të bëjë ndryshime në planin fillestar mësimor. Mësuesi mund të vendosë të përparojë më ngadalë nga sa e ka parashikuar, kur vë re se nxënësit e tij hasin vështirësi. Në këtë mënyrë mësuesi planifikon duke u bazuar në përparimin e nxënësve dhe në vështirësitë e hasura në periudhat paraardhëse, duke u përqendruar te arritjet e kompetencave kyç dhe të lëndës.

Planifikimi vjetor lëndor

Për planifikimin vjetor të lëndës, mësuesi, përveç programit mësimor duhet të njohë edhe tekstin që ka përzgjedhur për atë vit shkollor. Natyrisht, realizimi i programit është qëllimi i vërtetë i mësuesit, kurse teksti mësimor i përzgjedhur është një mjet për ta përmbushur këtë qëllim. Kur mësuesi sheh se teksti nuk i ka dhënë vendin e mjaftueshëm përvetësimit të një rezultati të nxëni të programit, ai e plotëson vetë këtë mungesë të tekstit, duke përdorur burime të tjera të nxëni.

Plani vjetor është një plan sintetik. Mësuesi planifikon orët dhe përmbajtjen kryesore lëndore për tri periudha. Periudhat janë:

- periudha e parë: shtator- dhjetor;
- periudha e dytë: janar - mars;
- periudha e tretë: prill- qershor.

Periudhat nuk janë semestra, por janë periudha reflektimi për mësuesit dhe nxënësit duke reflektuar mbi punën dhe rezultatet e tyre dhe si mund të përmirësohen ato në vazhdim.

Planifikimi sipas periudhave

Planifikimi i periudhës është një planifikim më afatshkurtër dhe më i detajuar i mësimdhënies. Ai është analitik dhe në të detajohen temat mësimore që do të zhvillohen përgjatë saj. Mësuesi harton planin e periudhës përkatëse në fillim të saj dhe e dorëzon në drejtorinë e shkollës para fillimit të periudhës. Ky plan hartohet duke iu përmbajtur programit dhe tekstit shkollor përkatës. Në planet sipas periudhave,

planifikohen të gjitha orët. Mësuesit janë të lirë të bëjnë ndryshimet e tyre hap pas hapi në varësi të specifikave të lëndës së tyre.

Ky lloj planifikimi kërkon që mësuesi të përcaktojë me kujdes:

a) Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç

Në këtë rubrikë mësuesi do të vendosë rezultatet e të nxënit të kompetencave kyç, të cilat do të zhvillohen nga nxënësit përgjatë temave mësimore, të zhvilluara gjatë kësaj periudhe. Mësuesi i përzgjedh këto rezultate në programin mësimor, te rubrika “Rezultatet kryesore të të nxënit, sipas kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës së matematikës”.

b) Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të lëndës

Në këtë rubrikë vendosen rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të lëndës, të cilat do të arrihen nga nxënësi nëpërmjet zhvillimit të këtyre temave mësimore. Mësuesi i përzgjedh këto rezultate të nxëni nga programi mësimor sipas tematikave të përmbajtjes së lëndës.

c) Numri rendor

Këtu vendosen numrat për temat mësimore. Totali i numrave në planin e periudhës përkon me numrin e orëve që janë përcaktuar në planin vjetor të lëndës ose të modulit.

d) Kapitulli

Në këtë rubrikë shënohen kapitujt mbi të cilat është ndërtuar teksti i lëndës.

e) Tema mësimore

Në këtë rubrikë shënohen të gjitha temat mësimore që do të zhvillohen gjatë periudhës. Kjo rubrikë përmban:

Orë të detyruara për t’u planifikuar:

 temat mësimore brenda të cilave do të realizohen rezultatet e të nxënit;

- orët e projektit kurrikular që do të zhvillojë mësuesi për zhvillimin e kompetencave të lëndës dhe të kompetencave kyç. Në planifikimin e projektit mësuesi duhet të ketë parasysh kohën e mjaftueshme

që duhet të lerë në dispozicion të orëve të projektit në mënyrë që t'u japë mundësi nxënësve të hulumtojnë dhe të zhvillojnë detyra kërkuese dhe krijuese. Zbatimi i një projekti kërkon më shumë se tri orë mësimore. Në planifikimet e periudhave, brenda orëve të planifikuara për zhvillimin e projektit, mësuesi bën kujdes të përfshijë edhe orët për prezantimin dhe vlerësimin e projektit.

📖 orë ushtrimesh, përpunim njohurish, përsëritje për testin përmbledhës etj., për të konsoliduar dhe për të zbatuar konceptet e fituara;

📖 orët e testeve ose të detyrave përmbledhëse (në lëndë të ndryshme mësimore mund të zhvillohen teste ose detyra përmbledhëse, sipas udhëzimit për vlerësimin e nxënësve në arsimin parauniversitar) për të matur njohuritë e fituara nga nxënësit në periudhën përkatëse. Mësuesi planifikon 3 teste ose detyra përmbledhëse, nga një për çdo periudhë. Testet ose detyrat përmbledhëse planifikohen kur mësuesi e shikon të arsyeshme kohën e zhvillimit të tij, d.m.th jo detyrimisht në fund të periudhës, por edhe disa javë përpara se të mbarojë periudha.

Orë opsionale për t'u planifikuar:

📖 orë për konkurse;

📖 orë për përsëritje;

📖 orë për analizë të testeve përmbledhëse;

📖 orë për ekskursione;

📖 etj.

f) Situata e të nxënit

Në këtë rubrikë vendosen situatat e të nxënit që mësuesi parashikon të realizojë gjatë periudhës, të cilat mund të ndryshohen dhe plotësohen përgjatë zhvillimit të lëndës. Nuk është e detyrueshme që situatat e të nxënit të vendosen të gjitha në fillim të hartimit të planit të periudhës. Situatat e të nxënit mund t'i përkasin një teme mësimore, disa temave mësimore, ashtu sikurse mund të ketë tema mësimore për të cilat mësuesi nuk zhvillon situata të nxëni. Me situatë të nxëni kuptohet ndërtimi i njohurive nëpërmjet një situatë praktike ose reale si pjesë e metodologjisë dhe organizimit të klasës.

g) Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Në këtë rubrikë mësuesi vendos në mënyrë të përgjithshme teknikat dhe metodat e mësimdhënies (p.sh., harta e konceptit, parashikimi me terma paraprakë, grupet e ekspertëve, punë në grup etj.) që do të

përdoren gjatë zhvillimit të këtyre temave në një periudhë të caktuar. Kjo rubrikë nuk është e detajuar për çdo temë mësimore sepse e tillë kjo rubrikë detajohet në planifikimin ditor.

h) Vlerësimi

Këtu vendosen në mënyrë të përgjithshme teknikat e vlerësimit që do të përdoren gjatë zhvillimit të këtyre temave në një periudhë të caktuar si p.sh., vlerësimi i përgjigjeve me gojë; vlerësimi i punës në grup; vlerësim mes nxënësish; vlerësim i aktivitetit gjatë debateve në klasë; vlerësim i detyrave të shtëpisë; vetëvlerësim; intervistë me një listë treguesish; vëzhgim me një listë të plotë treguesish; prezantim ose punë me gojë ose me shkrim; vlerësimi i projektit kurrikular etj. Kjo rubrikë nuk është e detajuar për çdo temë mësimore sepse e tillë kjo rubrikë detajohet në planifikimin ditor.

i) Burimet

Në këtë rubrikë në mënyrë të përgjithshme mësuesi vendos burimet që do të përdoren për arritjen e rezultateve të nxënësve si p.sh., teksti i nxënësve, teksti i ushtrimeve (nëse ka të tillë), materiale të përgatitura nga mësuesi ose nxënësi, tabletat, SmartLab-e etj. Kjo rubrikë nuk është e detajuar për çdo temë mësimore sepse e tillë kjo rubrikë detajohet në planifikimin ditor.

Planifikimi ditor

Mësuesi planifikon çdo orë mësimore. Në përgatitjen e një plani ditor mësuesi duhet të përcaktojë rezultatet e pritshme të asaj ore mësimi, të përgatisë veprimtaritë mësimore, të përzgjedhë metodat dhe strategjitë, të përzgjedhë burimet e të nxënësve, të përcaktojë teknikat e vlerësimit të përshtatshme për klasën, të parashikojë punën me klasën, grupet, nxënës të veçantë, të parashikojë lidhjen me lëndët e tjera etj.

Rubrikat e planit ditor:

- Fusha
- Lënda
- Shkalla (shënohet shkalla, duke iu referuar kornizës kurrikulare, III dhe IV)
- Klasa (shënohet klasa)
- Tema mësimore (shënohet tema mësimore)


- Situata e të nxënës (këtu shkruhet shkurtimisht tema e situatës së të nxënës), nëse mësuesi ka planifikuar një situatë. Nëse mësuesi nuk planifikon situatë për atë temë mësimi, nuk do të shkruajë asgjë në këtë rubrikë.
- Rezultatet e të nxënës (këtu vendosen rezultatet e temës mësimore që nxënësi do të arrijë gjatë orës së mësimit).
- Fjalët ose konceptet kyç të temës mësimore.
- Burimet që do të përdoren gjatë orës së mësimit.
- Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare, nëse ka.
- Metodologjia ose veprimtarinë e nxënësve (metodologjia për arritjen e rezultateve të të nxënës të orës së mësimit dhe veprimtaritë e nxënësve lidhen me situatën e të nxënës, nëse është planifikuar një e tillë).
- Vlerësimi (shënohen nivelet e arritjes dhe teknikat e vlerësimit).
- Detyrat e shtëpisë (shënohen detyrat e shtëpisë, nëse do të jepen).

Shënim: Modele të planeve vjetore, planeve të periudhës dhe planeve ditore gjenden në udhëzuesit kurrikularë lëndorë, ASCAP 2023 [Udhëzues Lëndorë | Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar \(ascap.edu.al\)](https://ascap.edu.al).

Plani Edukativ Individual

Plani Edukativ Individual (PEI) është:

- një dokument i shkruar, i cili përshkruan njohuritë dhe aftësitë, si dhe /apo shërbime që i nevojiten një nxënësi, bazuar në vlerësimin e përgjithshëm të nevojave dhe aftësive që ai ka; nevoja dhe aftësi të cilat ndikojnë në mundësitë e tij për të nxënë dhe për shprehur atë që ka nxënë;
- dokumentim i ndërhyrjeve të programuara, për të ndihmuar nxënësin të rritë pritshmëritë në të nxënë dhe të identifikojë pikat e forta dhe nevojat që ai ka në procesin e të nxënës;
- një dokument pune ku pasqyrohen përshtatjet e nevojshme të rezultateve të të nxënës në përmbushje të rezultateve që parashikohen dhe hartohen për nivelin arsimor përkatës, bazuar në nivelet e arritjeve të kompetencave;
- një instrument, për nxënësit, për prindërit e nxënësve dhe për të gjithë ata të cilët kanë përgjegjësi për edukimin formal, informal dhe joformal të nxënësve.



Plani Edukativ Individual (PEI):

- I jep mundësi nxënësit të progresojë në një nivel që përputhet me aftësitë e tij.
- Inkurajon dhe përfshin bashkëpunim mes të gjithë partnerëve (drejtues, mësues, staf ndihmës, prindër etj.).
- Përcakton strategjitë e mësimdhënies/nxënies për nxënësit me aftësi të kufizuara.
- Kontribuon në të kuptuarin e njëjtë nga ana e të gjithë anëtarëve të stafit mësimor të aftësive, interesave dhe nevojave të nxënësve me aftësi të kufizuara.
- Lehtëson identifikimin e përparësive në planifikim përgjatë gjithë fushave dhe lëndëve mësimore, duke i lejuar mësuesit të kenë objektiva/rezultate të njëjta.
- Siguron që të monitorohet dhe të vlerësohet e gjithë puna e bërë.
- Përfshin prindërit në procesin e ndërtimit të tij.
- Është realist dhe i arritshëm.
- Qartëson pritshmëritë e stafit pedagogjik dhe të profesionistëve të tjerë brenda dhe jashtë shkollës.
- Mundëson vazhdimësi të punës kur nxënësi transferohet nga një shkollë në tjetrën.

Kur hartohet Plani Edukativ Individual (PEI)?

PEI hartohet për të gjithë nxënësit për të cilët, nga komisioni në institucionet arsimore është marrë vendimi për ndjekjen me këtë plan. Një PEI hartohet pasi është kryer vlerësimi i fëmijës, sipas udhëzimeve të përcaktuara në Rregulloren e funksionimit të institucioneve arsimore në Republikën e Shqipërisë. Në rastet kur shihet se fëmija ka ndryshime të dukshme apo në të kundërtën, nuk ecën përpara aq sa pritet, mund të bëhet rivlerësimi edhe më herët se ç'parashikohet nga komisioni.

Si lidhet PEI me kurrikulën shkollore?

Natyra dhe shkalla e PEI-t ndryshon në varësi të nevojave të fëmijëve. Gjatë hartimit të një PEI, krahas rezultateve/objektivave që lidhen drejtpërdrejt me procesin mësimor, vendosen dhe objektiva për të realizuar shoqërizimin dhe zhvillimin brenda jetës shkollore. Në rastet kur parashikohet se nxënësit nuk mund të arrijë rezultatet e disa lëndëve mësimore apo fushave të veprimtarive, ajo lëndë mund të ndiqet me *plan të individualizuar*, kështu që caktohen objektiva individuale për fëmijën për atë lëndë. Në këtë rast, edhe vlerësimi bëhet në mënyrë individuale, në bazë të objektivave/ rezultateve të caktuara. Vendimi për individualizim duhet të vijë nga ekipi vlerësues pas vlerësimit të fëmijës. E veçanta e PEI-t qëndron në atë që ai përgatitet nga një grup ekspertësh, mësuesit si dhe me pjesëmarrjen e plotë të prindit. Një plan individual nuk është përsëritje e planeve të tjera, por duhet të jetë pjesë plotësuese e planifikimit shkollor. Mësuesi në shkollë punon duke iu referuar parimeve bazë të kornizës kurrikulare, për t'iu ofruar nxënësve një arsimim cilësor.

Është e natyrshme që PEI të integrohet brenda kurrikulës shkollore dhe nga ana tjetër kurrikula krijon hapësira për të hartuar PEI. Kjo ndërlidhje e PEI-t me kurrikulën shprehet në faktin që:

nëse kurrikula kërkon që të nxënësi të arrihen disa kompetenca kyç dhe specifike në formën e njohurive, aftësive, shkathtësive dhe qëndrimeve, plani PEI e mbështet këtë synim të kurrikulës dhe mundëson që të nxënësi të arrihen disa objektiva/rezultate në përshtatje me aftësitë, mundësitë dhe interesat e nxënësit, mbështetur në fushat e zhvillimit të tij.

- nëse kurrikula si parim të saj ka gjithëpërfshirjen dhe duhet të njohë, të pranojë, të respektojë dhe t'u përgjigjet nevojave, përvojave, interesave arsimore dhe vlerave të të gjithë grupeve të nxënësve, PEI është një instrument që e synon dhe mbështet gjithëpërfshirjen e nxënësit brenda mjedisit ku ai mëson.
- nëse kurrikula siguron njëherësh baraspeshën ndërmjet njohurive e aftësive të secilës fushë të nxëni, si dhe integrimin brenda dhe ndërmjet tyre, kjo është ajo që mund të shfrytëzohet te PEI lidhur me interesat dhe aftësitë e nxënësit.
- nëse kurrikula krijon hapësirë për fleksibilitet dhe autonomi, kjo bën që mësuesi të jetë i lirë të sigurojë, hapa, mjete, strategji e metoda mbi bazën e të cilave do të ndjekë ecurinë e PEI-t.

Cilat janë hapat e hartimit dhe të zbatimit të PEI-t?

Komisioni i shkollës i ngritur me qëllim hartimin e PEI-t, në bazë të vlerësimit dhe udhëzimit të dhënë nga komisioni në ZVA, harton PEI-n. Prindërit janë pjesë e ekipit. Takimi për ta shkruar PEI-n duhet të mbahet brenda afatit të përcaktuar nga komisioni vlerësues, pas marrjes së vendimit nga ky i fundit.

Të gjithë personat përgjegjës për zbatimin e PEI-t, duke përfshirë edhe prindërit, pajisen me një kopje të tij në mënyrë që të njohin rolet dhe përgjegjësitë e veta në plan. Anëtarët e komisionit takohen periodikisht për të parë ecurinë e zbatimit të PEI-t, bazuar në vendimet e komisionit vlerësues.

Komisioni i shkollës vlerëson se sa janë arritur objektivat/rezultatet e PEI-t në fund të çdo periudhe 3- mujore të parashikuar në planin PEI. Në bazë të arritjeve, komisioni bën rishikimin, përshtatjen, ndryshimin ose shtimin e këtyre objektivave/rezultateve. Ekipi i PEI-t mund të bëjë rishikim të objektivave/rezultateve të planit, kur e sheh të nevojshme, me qëllim përshtatjen sa më të mirë të ndërhyrjeve drejtuar nxënësit.

Nxënësi vlerësohet në përfundim të periudhës bazuar në rezultatet e PEI-t dhe sipas procedurave të përcaktuara në udhëzimin nr. 11, datë 26.06.2023 “Për një shtesë në udhëzimin nr. 17, datë 05.07.2022 “Për vlerësimin e nxënësve në sistemin arsimor parauniversitar”, i ndryshuar.

Struktura e planit edukativ individual (PEI)

Elementet kryesore të PEI-t janë:

a) Zhvillimi i nxënësit në fusha specifike

Në këtë pjesë jepen disa të dhëna personale për nxënësin dhe një përmbledhje e përshkrimit të gjendjes aktuale të nxënësit në bazë të fushave të zhvillimit të tij. Këto fusha janë:

- *Fusha e zhvillimit shqisor – motorik:* shkathtësitë e mëdha dhe të imëta motorike, ekuilibri, koordinimi sy-dorë, ritmi, tonusi i muskujve, lëvizja etj.
- *Fusha e zhvillimit të gjuhës dhe komunikimit:* komunikimi verbal (të folurit, shenjat, të shprehurit, fjalori, leximi) dhe joverbal (shkrimi, gjuha e shenjave, e simboleve, gjestet, gjuha trupore) etj.
- *Fusha e zhvillimit social – emocional:* shkathtësitë shoqërore dhe shkathtësitë për bashkëpunim, të shprehurit, identifikimi dhe menaxhimi i ndjenjave, vetëmenaxhimi etj.
- *Fusha e zhvillimit njohës:* përdorimi aktiv i shqisave, të kuptuarit, analiza, përzgjedhja, kategorizimi, zgjidhja e problemeve, të kuptuarit e shkakut dhe të pasojës etj.

- *Fusha e aftësive për jetën dhe autonominë personale:* pjesëmarrja aktive në mjedisin që e rrethon, niveli i iniciativës, niveli i pavarësisë, shëndeti, siguria, shkathtësitë për jetën, veprimtaritë e kohës së lirë etj.

b) Rezultatet e pritshme të nxënësit në fushat e zhvillimit dhe/ose në lëndët mësimore

Për fëmijët me AK të rënda ose të shumëfishta, kur mësimdhënia nuk është e mundur të organizohet sipas lëndëve mësimore, mund të organizohet përmes fushave të veprimtarive . Në këto raste procesi edukativ-mësimor mund të organizohet sipas fushave të mësipërme të veprimtarive.

Fushat e veprimtarive janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën dhe zhvillimi i njëres ndërlidhet me zhvillimin e tjetrës. Për disa nxënës mund të jetë e arsyeshme që procesi edukativo-mësimor të organizohet pjesërisht sipas lëndëve të (individualizuara), e pjesërisht sipas fushave të veprimtarive; nxënësi mund të aftësohet në një ose më shumë fusha veprimtarish, gjithmonë duke u bazuar në nevojat individuale të tij. Për secilën fushë të veprimtarive duhet të specifikohet nëse pritshmëritë janë arritur, duhet të përcaktohen pritshmëri të reja për fushat e zhvillimit, dhe nëse nuk janë arritur, duhet të rivlerësohen dhe riformulohen të zbërthyer në elemente më të thjeshta.

c) Strategjitë dhe metodat e mësimdhënies.

- d) Mjetet e punës:* Te mjetet e punës përkshkruhen të gjitha materialet didaktike që përdoren në klasë me nxënësit në arritjen e rezultateve, p.sh. përdorimin e mjeteve didaktike, mjeteve dhe programeve teknologjike, mjeteve ndihmëse, fotografive, ilustrimeve, lojërave logjike etj.
- e) Mbështetja shtesë nga burimet njerëzore:* Këtu përkshkruhen të gjitha shërbimet që merr nxënësi gjatë procesit mësimor si: mbështetja nga mësuesi ndihmës, mësuesi i klasës, ndihmësi personal i fëmijës (nëse ka), prindi, ndihma nga bashkëmoshatarët etj.
- f) Metodatat e vlerësimit:* Vlerësimi i fushës së veprimtarive duhet të bëhet në bazë të rezultateve të caktuara për atë fushë të veprimtarive. Vlerësimi duhet të bëhet nga të gjithë personat që kanë punuar me nxënësin në zhvillimin e asaj fushe veprimtarish. Është me rëndësi që në vlerësim të përfshihen edhe prindërit, sepse ata sjellin informacion të rëndësishëm për zhvillimin e nxënësit. Vlerësimi duhet të jetë me shkrim dhe përshkruar, duke mbuluar të gjitha elementet që përfshijnë fushat e veprimtarive.

Vlerësimi lëndor bëhet nga mësuesi i lëndës në bashkëpunim me mësuesin ndihmës, duke u konsultuar edhe me personat e tjerë që kanë hartuar PEI-n. Ky vlerësim bëhet në fund të çdo periudhe dhe në përfundim të vitit shkollor, sipas procedurave të përcaktuara në udhëzimin nr. 11, datë 26.06.2023 “Për një shtesë në udhëzimin nr. 17, datë 05.07.2022 “Për vlerësimin e nxënësve në sistemin arsimor parauniversitar”, i ndryshuar.

Model plani edukativ

Emri/mbiemri: _____ Klasa: I Datëlindja: __/__/____

Viti shkollor: _____

Prindërit/Kujdestarët _____

Shkolla: " _____ "

Gjuha bazë e fëmijës: Shqip

Gjuha e përdorur në familje: Shqip

Klasifikimi i paaftësisë: Autizëm

Çrregullim i mbivendosur: JO

Përshkrimi për 5 fushat e zhvillimit

Fusha e zhvillimit shqisor – motorik: ...

Fusha e zhvillimit të gjuhës dhe komunikimit: ...

Fusha e zhvillimit social – emocional: ...

Fusha e zhvillimit njohës: ...

Fusha e aftësive për jetën dhe autonominë personale: ...

Niveli aktual i performancës, qëllimet dhe rezultatet

Lënda: Abetare

Niveli aktual i edukimit, përfshin efektet e aftësisë së kufizuar në zhvillimin e kurrikulës së përgjithshme

Nxënësi XXXX është fëmijë joverbal, por që ka filluar të artikulojë një pjesë të konsiderueshme të tingujve duke i përdorur ato në fjalë. Shkruan saktë të gjitha shkronjat e mëdha të alfabetit. Arrin të bëjë diktim pjesën më të madhe të tyre. Njeh shkronjat e vogla të shtypit: a,b,c,e,f. Arrin të kopjojë fjalë e fjali të shkurtra, si dhe shkruan fjalë duke ia diktuar. Njeh funksionin e fjalëve duke i identifikuar joverbalisht. Lexon rrokje të formuara nga bashkëtingëllore dhe zanore të tingujve që artikulon. Formon rrokjet që i kërkojnë. Paraqet vështirësi në artikullimin e tingujve grykore si K, G, J, GJ.

Qëllimet (për vitin shkollor 202..- 202..)

Nxënësi do të arrijë:

- Të gjejë fjalë që fillojnë me shkronjën/tingullin e kërkuar.
- Të lexojë fjalë e fjali pavarësisht tingujve që nuk artikulon, duke rritur të kuptuarin e fjalëve që lexon.
- Të kopjojë pa gabime tekste të shkurtra.
- Të pasurojë fjalorin duke rritur të shprehurit verbal.

Rezultatet e të nxënit

Nxënësi:

- ndan fjalët në rrokje;
- kopjon fjalë të shkurtra;
- shpreh pa ndihmë fjali të thjeshta me 2 fjalë (dua ujë, dua të shkruaj, dua të vizatoj etj.);
- gjen fjalë që fillojnë me bashkëtingëlloret L, M, B, T, D, N, S, F. G.
- gjen fjalë që fillojnë me tingullin/shkronjën e kërkuar.

Lënda: Matematikë

Niveli aktual i edukimit, përfshirë efektet e aftësisë së kufizuar në zhvillimin e kurrikulës së përgjithshme

Nxënësi XXXX njih saktë numërorët 1-10. Njih sasinë e numërorëve 1-5. Paraqet herë pas here vështirësi në vendosjen e sasisë duke vazhduar numërimin si rutinë. Njih konceptet “i madh, i vogël”. Shkruan numërorët saktë si dhe në formë diktimi. Njih shenjat më i madh, më i vogël, baras dhe plus. Ka arritur të njohë 2 më i madh se 1 dhe anasjelltas si dhe 2+1, 1+2 si dhe 1+1. Plotëson pa ndihmë numërorin që mungon në vargun numerik 1-10. Punon në çdo aktivitet nëse njihet me kohën që ka në dispozicion. Kërkon pak vëmendje sa të vihet në punë dhe më pas nuk ka nevojë për ndihmë veç pak nxitje verbale për të përfunduar detyrën.

Qëllimet (për vitin shkollor 202..- 202..)

Rezultatet e të nxënit

Lënda: **Dituri natyre**

Lënda: ...

Edukimi special dhe shërbimet e përfituara

<i>Lloji i shërbimit, Ndihma / ndërhyrja</i>	<i>Vendi</i>	<i>Koha për ditë/javë</i>	<i>Data e fillimit</i>	<i>Kohëzgjatja</i>
Mësuese ndihmëse	Klasë	-- orë në ditë	...	--ora mësimore

Pjesëmarrje në kurrikulën e përgjithshme

Klasë e rregullt në kurrikulën e përgjithshme:

Nxënësi XXXX do të ndjekë programin e klasës së cilën frekuenton. Nxënësi XXXX ka mundësinë të ndjekë programin e klasës me rezultate të kënaqshme duke u mbështetur me terapi jashtë shkolle.

Pjesëmarrje në vlerësimet nga ministria ose ZVA

E rregullt

E modifikuar Oraret Vendndodhja Formatet e përgjigjeve Formatet e prezantimeve

Alternativa: _____

Arsye për alternativë: _____

Kalendari i raportimeve tek prindërit

Javore Mujore Raporte për progresin e fëmijës SMIP

Dyjavore 3-mujore Shënime në shtëpi Të tjera_____

Firma	Pozicioni	Data
_____	_____	_____
_____	_____	_____
_____	_____	_____
_____	_____	_____
_____	_____	_____

Struktura e planit ditor për mësuesin ndihmës

Rubrikat e planit ditor për mësuesin ndihmës:

- Rezultatet e të nxënit të lëndëve mësimore (në bashkëpunim me mësuesit lëndorë) dhe/ose objektivat për fushat e zhvillimit
- Materialet mësimore
- Përshkrimi i veprimtarive në lëndët mësimore sipas orarit mësimor

P.sh.: Gjuhë shqipe

- Leximi i një teksti të thjeshtë deri në 100 fjalë.
- Përdorimi i materialeve me tekst dhe figura për të përmirësuar kuptimin.

Pushim dhe kohë e veçantë për ndihmë dhe stimulim sensorial sipas nevojave të nxënësit.

Matematikë:

- Zhvillimi i ushtrimeve të thjeshta matematikore me përdorim të materialeve praktike.
- Kohë e lirë për lojë dhe ndërveprim social.



Edukim muzikor

- *Këndimi i një kënge në kor së bashku me nxënësit e tjerë.*
- Vlerësimi i nxënësit.
- Detyra në shtëpi (në bashkëpunim me prindërit).

III. ZBATIMI I KURRIKULËS ZYRTARE PËR FËMIJËT ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Arsimi gjithëpërfshirës është bërë një gur themeli i pedagogjisë moderne, duke u përpjekur të sigurojë që çdo fëmijë, pavarësisht nga aftësitë e tij, të marrë arsim cilësor në klasat e zakonshme. Si mësues ndihmës, roli juaj në zbatimin e kurrikulës zyrtare për fëmijët me aftësi të kufizuara është thelbësor në nxitjen e një mjedisi mësimor gjithëpërfshirës ku çdo fëmijë mund të ndjehet i përfshirë dhe të ketë sukses. Ky kapitull do t'ju udhëheqë përmes hapave dhe strategjive thelbësore për të zbatuar në mënyrë efektive kurrikulën zyrtare për fëmijët me aftësi të kufizuara në shkollat e zakonshme.

Të kuptuarit e kurrikulës zyrtare:

Përpara se të thelloheni në strategjitë e zbatimit, është thelbësore të keni një kuptim gjithëpërfshirës të kurrikulës zyrtare të krijuar për fëmijët me aftësi të kufizuara. Njihuni me objektivat e kurrikulës, përmbajtjen dhe qasjet mësimore të përshtatura për të përmbushur nevojat e ndryshme të nxënësve me aftësi të kufizuara. Ky kuptim do të shërbejë si bazë për praktikën tuaj të mësimdhënies dhe do t'ju ndihmojë të merrni vendime të informuara për të mbështetur të nxënësit e studentëve.

Planet Edukative Individuale (PEI):

Bashkëpunoni ngushtë me mësuesin e klasës dhe profesionistët e arsimit special për të zhvilluar dhe zbatuar Plane Edukative Individualë (PEI) për nxënësit me aftësi të kufizuara. PEI-të përshkruajnë qëllime specifike të të mësuarit, përshtatje dhe modifikime për nevojat e veçanta të secilit nxënësi. Si një mësues ndihmës, njohuritë tuaja për përparimin dhe sfidat e nxënësve do të jenë të paçmueshme në përgatitjen dhe përshtatjen e PEI-ve për të siguruar mbështetje optimale dhe rritje akademike.

Udhëzime të diferencuara:

Përvetësoni një qasje fleksibël dhe të përgjegjshme ndaj mësimdhënies duke përdorur strategji të diferencuara të mësimdhënies që plotësojnë nevojat e ndryshme të të nxënësit brenda klasës. Siguroni rrugë dhe mundësi angazhimi për të përshtatur stilet dhe aftësitë e ndryshme të të mësuarit. Përdorni mjete ndihmëse vizuale, teknologji ndihmëse dhe aktivitete të larmishme për ta bërë mësimin të arritshëm dhe kuptimplotë për të gjithë nxënësit.



Mjedis mësimor bashkëpunues:

Krijoni një kulturë bashkëpunimi dhe gjithëpërfshirëse në klasë, ku nxënësit me aftësi të kufizuara të ndjehen të vlerësuar, të mbështetur dhe të fuqizuar për të marrë pjesë aktive në procesin e të nxënësve. Inkurajoni ndërveprimet me bashkëmoshatarët, aktivitetet e të mësuarit në bashkëpunim dhe mundësitë e të nxënësve me bashkëmoshatarët, për të nxitur përfshirjen sociale dhe mbështetjen e ndërsjellë midis nxënësve. Theksoni rëndësinë e ndjeshmërisë, respektit dhe pranimit për të kultivuar një komunitet pozitiv të të mësuarit ku respektohen dallimet.

Vlerësim dhe Monitorim i Progresit:

Zbatoni një sërë metodash dhe mjete vlerësimi për të monitoruar përparimin e nxënësve, për të vlerësuar rezultatet e të nxënësve dhe për të informuar vendimmarrjen mësimore. Përdorni vlerësime formuese, portofol, vëzhgime dhe detyra të bazuara në performancë për të mbledhur prova autentike të të nxënësve të studentëve. Rishikoni dhe përmirësoni rregullisht strategjitë mësimore bazuar në të dhënat e vlerësimit, për të adresuar nevojat individuale të të mësuarit dhe për të siguruar akses të barabartë në kurrikul.

Zhvillim dhe Bashkëpunim Profesional:

Angazhohuni në mundësitë e vazhdueshme të zhvillimit profesional për të përmirësuar njohuritë, aftësitë dhe kompetencat tuaja në mbështetjen e nxënësve me aftësi të kufizuara. Merrni pjesë në seminare, workshope dhe trajnime të fokusuara në arsimin gjithëpërfshirës, në praktikën më të mirë të arsimit special dhe teknologjitë ndihmëse. Bashkëpunoni me kolegët edukatorë, specialistët e arsimit special dhe stafin mbështetës për të ndarë njohuri, burime dhe strategji për të përmbushur në mënyrë efektive nevojat e nxënësve të ndryshëm.

Si përfundim:

Zbatimi i kurrikulës zyrtare për fëmijët me aftësi të kufizuara në shkollat e zakonshme kërkon përkushtim, kreativitet dhe një angazhim të thellë ndaj praktikave gjithëpërfshirëse. Si mësues ndihmës, ju luani një rol jetësor në krijimin e një mjedisi mësimor mbështetës dhe pasurues, ku çdo nxënës mund të arrijë potencialin e tij të plotë.



Duke kuptuar kurrikulën, duke individualizuar mësimdhënien, duke nxitur bashkëpunimin dhe duke përmirësuar vazhdimisht praktikën tuaj të mësimdhënies, ju mund të bëni një ndryshim të rëndësishëm në jetën e nxënësve me aftësi të kufizuara. Mos harroni, ***gjithëpërfshirja nuk është vetëm një qëllim; është një parim themelor që drejton përpjekjet tona për të siguruar që çdo fëmijë të marrë arsimin që meriton.***

Përshkrim i detajuar i lëndës Gjuhë shqipe

Temat për lëndën Gjuhë shqipe

Lënda është konceptuar në pesë linja kryesore të cilat janë:

- Shkrimi (elementë shkrimi dhe grafizëm).
- E folura e kuptueshme
- Leximi
- Dëgjimi /kuptimi
- Komunikimi joverbal

Linja: Shkrimi (elementë shkrimi dhe grafizmi)

Temat(përgatitje për shkrim)	Rezultatet e pritshme
▪ Mbushje/ zbrazje e objekteve.	➤ Të koordinojë sy-dorë-duar.
▪ Ushtrime me gishtat, duart dhe trupin.	➤ Të zotërojnë tonusin e duhur të muskulaturës së duarve për procesin e shkrimit. ➤ Të kapë/ mbajë objekte të madhësive e peshave të ndryshme.
▪ Përdorimi i pincës.	➤ Të kapë me pincë (gishti i madh dhe tregues) objekte të vogla.
▪ Shtypje butonash me një gisht.	➤ Të shtypë me një gisht butona me rezistencë të ndryshme.
▪ Zbërthim/heqje kapaku.	➤ Të zbërthejë/ heqë kapakun e shishes.
▪ Hapje/ mbyllje kapaku, kapëse rrobash etj.	➤ Të hapë / mbyllë kapëset për të.
▪ Palosje letre ...	➤ Të palosë më dysh, katërsh.
▪ Grisje letre, kartoni.	➤ Të grisë duke koordinuar duart.
▪ Pineska	➤ Të ngulë pineska në materiale të ndryshme.
▪ Rreshtim objekte/ figura.	➤ Të rreshtojë objekte/ fig. nga e majta në të djathtë.
▪ Ndërtim “Kala”	➤ Të ndërtojë kala me kuba...

- Shkrim dhe vizatim (grafizëm) në materiale rrethore në miell, oriz, ujë, plastelinë.
 - Të imitojë lëvizje me gisht, (sikur po vizaton një figurë apo shkruan një shkronjë) me duart dhe trup.
 - Të realizojë gjurmë ose figura në ujë, oriz, rërë, miell, plastelinë.
- Shkrim me penel.
 - Të realizojë lëvizje me penel e ngjyra uji.
 - Të shkruajë me penel ose shumës
- Lëvizje rrotulluese, vertikale, horizontale, zigzage të mëdha në dërrasë, në tokë, në rërë, në tabak të madh, në fletë A4 etj.
 - Të mbajë fletën me dorën tjetër.
 - Të mbajë korrekt drejtimin e trupit (posturën).
- Realizimi i gjurmëve me kaçavidë dhe laps në plastelinë.
 - Të realizojë gjurmë me kaçavidë ose materiale të tjera në plastelinë.
- Realizimi i pikave në fletë në formën e gjurmëve me kolor, me vula, me modele etj.
 - Të realizojë shkarravina, lëvizje rrethore, vertikale, horizontale zigzage etj. në tabelë, në tokë, në rërë, në ujë, në tabakë të mëdhenj, në fleta A4 etj., me mjete rrethore.
 - Të vulosë në tabelë, në tokë, në rërë, në ujë, në tabakë të mëdhenj, në fleta A4 etj., me mjete rrethore.
- Qarkim objekti me fill, litarë, tela dhe materiale të tjera rrethore.
- Qarkim objekti me laps në libër ose fletore.
 - Të qarkojë me fije ose litarë një objekt.
 - Të qarkojë në fletë ose libër me figura, shkronja ose fjalë.
 - Të realizojë gjurmë pikash në tabak të madh, në fletë A4 dhe në një sipërfaqe të kufizuar me kolor, penel etj.
- Ngjyrosje me laps, kolor, penel, me bojëra uji në tabak, në fletë A4, në dërrasë, në bukë peshku, në materiale pikturë etj.
- Ngjyrosje brenda kontureve e figurave dhe shkronjave.
 - Të ngjyrosë brenda kontureve.
 - Të mbështesë bërrylin dhe kyçin tek fleta kur ngjyros.
 - Të mbajë fletën me dorë kur ngjyros.
- Bashkim pikash horizontale dhe vertikale.
 - Të bashkojë pika.
 - Të lidhë me shigjetë figura të ngjashme, fjalë të njëjta etj.

- | | |
|--|---|
| ▪ Ndjekja e një linje pikash horizontale, vertikale, zigzage etj. | ➤ Të ndjekë një vazhdueshmëri pikash në drejtim horizontal, vertikal, rrotullues, zigzag etj. |
| ▪ Riprodhimi i një figure të thjeshtë duke kopjuar modelin. | |
| ▪ Skicimi i një rrugëtimi në një labirint të thjeshtë. | ➤ Të ndjekë një rrugëtim në një labirint të thjeshtë. |
| ▪ Skicimi i një rrugëtimi në një labirint kompleks. | ➤ Të ndjekë një rrugëtim në një labirint të komplikuar. |
| ▪ Vizatimi i njeriut. | ➤ Të vizatojë një figurë të thjeshtë duke vëzhguar modelin ose duke punuar mbi të. |
| ▪ Shkrim i grafikut të shkronjave. | ➤ Të ngjyrosë brenda kontureve shkronja dhe figura. |
| ▪ Shkrim mbi model i grafikut të shkronjave. | ➤ Të shkruajë grafikun e shkronjave mbi model ose duke i kopjuar. |
| ▪ Lidhja e grafikut të shkronjës me tingullin përkatës. | ➤ Të lidhë tingullin me grafikun e shkronjës. |
| ▪ Kopjim i rrokjeve, fjalëve duke filluar me dy rrokje dhe fjalive. | ➤ Të shkruajë fjalë mbi model ose t'i kopjojë ato. |
| ▪ Diktim shkronje, rrokje, fjale dhe fjalie. | ➤ Të realizojë shkronja fjalë ose fjali me diktim. |
| ▪ Qarkim në fletë ose libër i shkronjave, fjalëve, fjalive dhe figurave. | |
| ▪ Shkrim i fjalëve të verbalizuara nga nxënësit ose të menduara prej tij. | ➤ Të shkruajë fjalë ose fjali të menduara prej nxënësit. |
| ▪ Shkrim i fjalëve apo fjalive duke përdorur mjetet e teknologjisë si kompjuter apo telefon. | ➤ Të shkruajë duke përdorur mjetet teknologjike |
| ▪ Përdorimi i shenjave të pikësimit, shkronjës së madhe. | ➤ Të përdorë korrekt shenjat e pikësimit e shkronjën e madhe. |
| ▪ Orientimi në fletë për datën, titullin. | ➤ Të shkruajë në vendin dhe pozicionin e duhur datën, titullin, emrin. |
| ▪ Shkrime të shkurtra | ➤ Të shkruajë një urim, porosi, dëshirë... |

Linja: Të folurit

Temat	Rezultatet e pritshme
▪ Ushtrime buko-faciale për muskulaturën e gojës. ▪ Pirja me pipë dhe fryrja me të. ▪ Përlypje e ushqimeve të lëngëta, me konsistencë dhe të forta. ▪ Ushtrime të frymëmarrjes.	➤ Të forcohet muskulatura e gojës. ➤ Të fryje dhe të pijë me pipë. ➤ Të përlypë ushqime me fortësi të ndryshme. ➤ Frymëmarrje me gojë dhe nxjerrje me gojë. ➤ Frymëmarrje me gojë dhe nxjerrje me hundë. ➤ Frymëmarrje me hundë dhe nxjerrje me gojë. ➤ Frymëmarrje me hundë dhe nxjerrje me hundë. ➤ Fryrja e flakës, letrave, fijeve, fluskave të sapunit, tullumbaceve, e ujit me pipëza etj. ➤ Fryrja e veglave frymore, faqeve etj. ➤ Lirimi i ajrit me forcë pa hapjen e buzëve. ➤ Të marrë frymë me ritme, fuqi, thellësi të ndryshme.
▪ Flasim dhe imitojmë para pasqyrës. ▪ Imitim i tingujve. ▪ Imitim i mimikave, emocioneve	➤ Të imitojë të folurin si bebet. ➤ Të imitojë mimika dhe emocione. ➤ Të imitojë tinguj e rrokje. ➤ Të imitojë mimika sikur...
▪ Respektimi i radhës dhe kërkesa duke ngritur dorën.	➤ Të presë radhën në aktivitete.
▪ Përvetësimi i një fjale që zëvendëson /ndihmon komunikimin.	➤ Të shqiptojë p.sh “JA”. ➤ Të thotë fjalë për të tërhequr vëmendjen.
▪ Emërtim i objekteve, figurave etj.	➤ Të emërtojë objekte dhe figura (fjalë dy rrokëshe të drejta si gota, buka etj.).

- sendet e klasës;
- orendi të shtëpisë;
- veshjet ;
- perimet;
- frutat;
- kafshët e egra;
- kafshët e buta
- ushqime të përditshme, etj.

- Fjalët JO/PO.
 - Të përgjigjet me JO/PO në situata të thjeshta e të afërta me përditshmërinë.
 - Të kuptojë pohimin dhe mohimin
- Emri i vet, shokët dhe mësuesen me emrat e tyre.
 - Të thotë emrin e vet, shokut...
- Kërkesa për objektet e preferuara me fjalë ose fjali.
 - Të flasë ose të shtrojë kërkesa me fjalë ose fjali të thjeshta.(jepe, dua..)
- Përdorim përemrat “unë” dhe “ti”
 - Të përdorë përemrat “unë” dhe “ti”.
- Përdorimi i përemrave “Kur”, “Ku”, “ Çfarë”, “Si”, “ Përse” etj.
 - T’u përgjigjet pyetjeve me përemrat pyetës: “ku, çfarë, për çfarë, kujt, përse, kur si etj.
- Kërkesa për ndihmë.
 - Të kërkojë ndihmë verbalisht dhe me gjeste.
- Përdorimi i mbiemrave.
 - Të flasë rreth një figure.
 - Të ritregojë një përrallë ose një ndodhi të ditës.
- Tregim përralle.
- Bisedë rreth një ngjarje dhe ndodhie të ditës.
 - Të tregojë një ngjarje apo ndodhi të jetës së përditshme me ndihmën e pyetjeve të shtuara nga i rrituri ose të shprehura spontanisht.
- Memorizim dhe recitim i një vjershe, gjëagjëzë etj.
 - Të memorizojë një vjershë apo gjëagjëzë.
 - Të recitojë një vjershë.
 - Të pasurojë fjalorin me fjalë dhe shprehje të reja të dëgjua në diskutime të rutinës së përditshme.

Linja: Të dëgjuarit/ të kuptuarit

Tema	Rezultatet e pritshme
▪ Reagimit ndaj emrit të vet.	➤ Të kthejë kokën kur dëgjon emrin. ➤ Të reagojë ndaj emrit të vet.
▪ Vendorsja e kontaktit me sy nëpërmjet stimujve auditivë bashkangjitur dhe ata të prekjes, me gjeste, mimika, lodra, mimikë.	➤ Të shikojë në sy mësuesen apo bashkëbiseduesin. ➤ Të shikojë në sy dhe ta ruajë kontaktin nën ndikimin e stimujve perceptivë.
▪ Tregimi me gisht	➤ Të identifikojë shokët dhe mësuesen, objekte të emërtuara.
▪ Diskriminimi auditiv.	➤ Të identifikojë personin nga zëri. ➤ Të identifikojë zhurmat e objekteve, frymorëve (njeri ose kafshë), dukurive natyrore etj. nëpërmjet tingujve të tyre specifike. ➤ Të identifikojë tingujt e bashkëtingëlloreve dhe zanoreve. ➤ Lojë të gjejë shokun nëpërmjet zërit të tij. ➤ Lojë identifikim i objektit, frymorit (njeri ose kafshë), dukurisë natyrore etj. nëpërmjet tingujve specifike.
▪ Reagimi ndaj lartësisë, intonacionit të zërit.	➤ Të reagojë ndaj ndryshimit të tonit e lartësisë së zërit. ➤ Dramatizime.
▪ Dallimi i tingujve të zanoreve dhe bashkëtingëlloreve.	➤ Të identifikojë tingujt e bashkëtingëlloreve dhe zanoreve
▪ Dëgjimi i një përralle, kënge, vjershe.	➤ Të thotë/këndoje vjersha të vogla mundësisht shoqëruar me gjeste. ➤ Të njohë personazhet e përrallës.
▪ Komanda me 1, 2 veprime. (futet folja)	➤ Të tregojë ose të japë një objekt sipas komandës verbale ose me gjeste. ➤ Të zbatojë komanda të rutinës së përditshme. ➤ Të zbatojë rregullat e klasës dhe lojës në grup. ➤ Të presë radhën në aktivitete.

Linja: Të lexuarit

Tema	Rezultatet e pritshme
▪ Rreshtimi objekteve, figurave nga e majta në të djathtë.	➤ Të rreshtojë objekte, figura nga e majta në të djathtë.
▪ Shfletim i librit dhe tregim me gisht.	➤ Të shfletojë librin dhe të tregojë me gisht.
▪ Mbajta e librit në pozicionin e të lexuarit.	➤ Të zbatojë komandat e hapjes dhe mbylljes së librit. ➤ Të mbajë librin në pozicionin e të lexuarit.
▪ Identifikim figure dhe objekti duke e treguar me gisht, qarkuar apo emërtuar	➤ Të identifikojë një objekt duke e emërtuar, duke e treguar me gisht apo qarkuar.
▪ Grupim i objekteve sipas një karakteristike p.sh kafshë, fruta, mjete transporti simbole etj.	➤ Të grupojë figura ose objekte sipas një karakteristike fruta, perime, mjete transporti etj.
▪ Ushtrime për të gjetur ndryshimet në figurë.	➤ Të identifikojë ndryshimet në figurë.
▪ Identifikim i simboleve (ËC, Posta, Spitali, dyqane etj).	➤ Të identifikohen simbolet kryesore të tualetit, postës etj.
▪ Njohja si figurë e zanoreve (A,E,O,U,E).	➤ Të dallojë si figurë zanoret.
▪ Lexim global i emrit të vet, shokut.	➤ Të lexojë globalisht emrin e vet, të shokut... ➤ Të identifikojë globalisht emrin e vet, të shokut. ➤ Qarkim/ lidhje me vije e etiketës me emrin e vet, të shokut.
▪ Njohja e bashkëtingëlloreve si fig.	➤ Të dallojë si fig. Bashkëtingëlloret.
▪ Lexim global fjalë që fillojnë me bashkëtingëlloren e mësuar.	➤ Të lexojë globalisht fjalë dy rrokëshe që fillojnë me bashkëtingëlloren e mësuar në etiketë, në kompjuter, në tabelë etj. ➤ Të lidhë me shigjetë ose të bashkoj figurën me fjalën.
▪ Lexim fjalie me dy, tre fjalë.	➤ Të lexoj një fjali me dy/tre fjalë.
▪ Lexim tekstit dhe komentimi i tij.	➤ T'i përgjigjet pyetjeve rreth tekstit.
▪ Dallimi i titullit, autorit dhe faqes së parë e të fundit në një libër.	➤ Të dallojë titullin, autorin dhe faqen e parë të librit.

- Lexim i shkronjave, fjalëve apo teksteve, figurave me mjetet e teknologjisë moderne si kompjuter, telefon, video projektor.
- Të lexohet duke përdorur teknologjinë moderne.
- Të lexojë fjalë dhe shprehje të reja të dëgjuara në diskutime të rutinës së përditshme.

Linja: Komunikimi jo verbal

Temat	Rezultatet e pritshme
▪ Nxitja e reagimeve ndaj të prekurit, gudulisë dhe lojërave trupore.	➤ Të reagojë ndaj stimujve të prekjes, gudulisë dhe ngacmimeve të tjera trupore.
▪ Nxitja e reagimeve me ndihmën e disa shenjave (marrja e sapunit do të thotë do të shkojmë në tualet).	➤ Të kuptojë funksionin e një objekti dhe ta lidhë atë me një gjest.
▪ Mësojmë mimikat dhe emocionet me figura, me gjeste, piktograma etj.	➤ Të reagojë ndaj mimikave si "i kënaqur, i mërzhitur, ulla etj."
▪ Nxitja e shikimit drejt një objekti të treguar nga një i rritur.	➤ Të ndjekë të rriturin kur i demonstron një objekt apo figurë.
▪ Lojëra për mbajtjen e kontaktit me sy.	➤ Të ndjek me sy objektin që po tregon.
▪ Shenjat e pohimit dhe mohimit.	➤ Të kuptojë shenjat e mohimit dhe pohimit të paraqitura me gjeste ose verbalisht.
▪ Mësojmë shenjat p.sh qetësi, ulu etj.	➤ Të kuptojë shenjat e trupit p.sh gishtit tek buza për "qetësi" apo lëvizja e dorës për "ulu".
▪ Mësojmë simbolet e rutinës së përditshme (restoranti, farmaci, spital, dyqan etj.)	➤ Të njohë simbolet e rutinës së përditshme (kafene, tualet etj).
▪ Reagim me veprime pyetjeve të mësuesit p.sh "Ku është topi", fëmija shkon e merr apo e tregon me gisht.	➤ Të reagojë me veprime ndaj pyetjeve/kërkesave të të rriturit.
▪ Përshëndetja "mirupafshim" apo veprime të tjera përshëndetëse.	➤ Të bëjë gjestin mirupafshim.
▪ Tregim me gisht i një objekti, vendi, njeriu apo figure të kërkuar.	➤ Të tregoj me gisht një figurë apo objekt.

- Shkojmë me mësuesen tek objekti që dëshirojmë. ➤ Të kapë mësuesen për dore për të treguar objektin që dëshiron.
 - Imitim i veprimeve të rutinës së përditshme si p.sh “pi ujë”, ha bukë”, “më dhemb barku” etj. ➤ Të imitojë sikur pi ujë...
 - Imitojmë funksionin e një objekti. ➤ Të imitojë funksionin e një objekti p.sh makina ecën në rrugë dhe bën pip pip.
➤ Të tregojë me veprime në formën e imitimit nevojat, kërkesat , gjendjen e tij emocionale dhe shqetësimet e tij.
 - Vizatojmë kërkesën apo ndjesitë tona. ➤ Të vizatojë objektin e kërkuar apo shqetësimet e veta.
- Shkruajmë me fjalë ose fjali kërkesat apo ndjesitë tona në fletë, kompjuter etj. ➤ Të shkruajë me fjalë ndjesitë dhe shqetësimet e veta.

Tema	Rezultatet e pritshme	I pamundur	I paarritur	Me ndihmë fizike dhe verbale	Me ndihmë verbale		Pa ndihmë	
					Pa saktësi	Me saktësi	Pa saktësi	Me saktësi

Përshkrim i detajuar i lëndës Matematikë

Lënda: Matematikë & Zhvillim logjik

Njohuritë që trajtohen në lëndën e matematikës janë konceptuar në katër linja kryesore:

- Gjeometria (skema trupore, orientimi në hapësirë dhe në kohë)
- Modelet dhe marrëdhëniet (zhvillimi i shqisave - perceptimi)
- Matjet (të kundërtat dhe krahasimi)
- Numri dhe veprimet (Numri -sasia)

Linja: Gjeometria (skema trupore, orientimi në hapësirë dhe në kohë)

Njohuritë	Rezultatet e pritshme
A - Skema trupore	
1. Identifikimi tek vetja (prek/ trego me gisht/ emërto; në pozicionin ulur, në këmbë, shtrirë)	➤ Të njohë veten dhe kuptojë trupin e tij.
1.1 Pjesët e kokës, (sytë, hunda, goja, veshët, flokët)	➤ Të tregojë me gisht shqisat tek vetja.
1.2 Gjymtyrët (duart, këmbët)	➤ Të tregojë me gisht tek vetja kokën, gjymtyrët, trungun.
1.3 Trupi	
2. Identifikimi tek të tjerët (prek/ trego me gisht/ emërto; në pozicionin ulur, në këmbë, shtrirë)	➤ Të tregojë me gisht shqisat tek të tjerët.
2.1 Pjesët e kokës, (sytë, hunda, goja, veshët, flokët)	➤ Të tregojë me gisht tek shoku, kukulla kokën, gjymtyrët, trungun.
2.2 Gjymtyrët (duart, këmbët)	➤ Të tregojë në figurë kokën, gjymtyrët, trungun.
2.3 Trupi	➤ Të tregojë në figurë pjesët e kokës.
3. Modelim me materiale të ndryshme në 3D (plastelinë, brumë, gomë, etj.)	➤ Të realizojë skemën trupore me materiale si brumë, plastelinë etj.
3.1 Pjesët e kokës, (sytë, hunda, goja, veshët, flokët)	
3.2 Gjymtyrët (duart, këmbët)	
3.3 Trupi	
3.4 Plotëso pjesët që mungojnë	
4. Aplikacion	➤ Të realizojë skemën trupore me aplikacion me letër, karton e mjete rrethimore.
4.1 Pjesët e kokës, (sytë, hunda, goja, veshët, flokët)	➤ Të plotësojë pjesët e munguara.
4.2 Gjymtyrët(duart, këmbët)	
4.3 Trupi	

4.4 Plotëso pjesët që mungojnë

5. Vizatim

- 5.1 Vizatimi i vetë fëmijës në pozicion shtrirë, në këmbë, dorën këmbën etj. (në përmasa reale).
- 5.2 Vendosja e shqisave (sytë, goja, veshët, hunda) mbi model, me model, pa model.
- 5.3 Vizatimi i trungut të trupit mbi model ,me model, pa model.
- 5.4 Vendosja e gjymtyrëve me vizatim mbi model, me model, pa model.
- 5.5 Plotëso pjesët e kokës apo trupit që mungojnë.

- Të vizatojë njeriun.
- Të plotësojë pjesët e munguara.
- Të operojnë konkretisht me mjete dhe në jetën e përditshme me këto koncepte.

B - Orientimi në hapësirë

Konceptet që do të trajtohen janë:

- Brenda - jashtë
- Lart - poshtë
- Këtu - atje
- I madh - i vogël
- Para – prapa
- Boshti numerik
- I gjatë - i shkurtër
- Afër - larg
- Mbi - nën , poshtë
- I hollë - i trashë
- Majtas – djathtas - anash

- Orientimi në mjedisin e klasës si vendi i vet, tabela... sipas komandës së dhënë (Shko në bankë)
 - Gjetja e objektit sipas komandës së dhënë (Më sill shukumësin, etj.)
 - Gjetja e personit sipas komandës së dhënë (Eja tek mësuesja. Shko tek shoku. etj.)
 - Orientimi në mjediset e shkollës si kabineti i muzikës, palestra, etj.)
 - Orientimi në mjediset e jashtme të shkollës.
 - Lojë me kuba me dhe pa model.
 - Lojëra me fshehje të objekteve, personave, vetë individit.
 - Modele me petëza ose materiale të tjera.
 - Tabelat me rreshta e kolona
- Të orientohet duke zbatuar komanda të thjeshta në lidhje me zhvendosjen brenda klasës, në ambientet e brendshme dhe të jashtme të shkollës të objekteve dhe vetes.
 - Të operojë me këto koncepte në situata konkrete me objekte/figura.
 - Të ndjekë itinerare të thjeshta në mënyrë grafike, bashkim pikash , labirinte.
 - Të ndërtojë me lodra ndërtimore me dhe pa model.
 - Të realizojë figura me petëza plotësuese/pazëll (me 2-8 pjesë).
 - Të lokalizojë objekte apo sende.
 - Të ndërtojë tabela me kolona e rreshta.

Trajtimi i koncepteve të hapësirës do të bëhet duke ndjekur këtë metodikë:

a) Koncepti “Brenda- jashtë” aktivitete **me objekte**
p.sh: “lodrat në kuti”.

b) Koncepti “Brenda- jashtë” aktivitete **me figura**
p.sh.: ngjyros, vizato, ngjit, lyej brenda/jashtë figurës.

c) Koncepti “Brenda- jashtë” aktivitete në **situatë konkrete**.

Sqarim : Në të njëjtën mënyrë trajtojmë çdo koncept.

C - Orientimi në kohë

Konceptet e kohës:

- tani- pastaj
- mëngjes, drekë, darkë, pasdite etj.
- Ora
- Intervale kohore (pas 1 ore, për 5 minuta, në 08.00 etj.)
- ditë- natë
- ditët e javës
- stinët e vitit
- muajt e vitit

Regjimi ditor (veprimet që bëhen në mëngjes, në drekë, në darkë)

- | | |
|--|---|
| <ul style="list-style-type: none">▪ Orientimi në kohë (tani, pastaj) veprimtari konkrete.▪ Dallimi mëngjes, drekë, darkë (aktivitete praktike).▪ Ditët e javës (formimi i kalendarit javor).▪ Stinët e vitit (kalendar stinor) karakteristikat e stinëve si imazhe.▪ Muajt e vitit (kalendar mujor). | <ul style="list-style-type: none">➤ Të operojnë konkretisht në jetën e përditshme me këto koncepte.➤ Të njohin orën si mjet matës i kohës.➤ Të dallojnë ditën nga nata.➤ Të njohin/ emërtojnë ditët e javës.➤ Të njohin/ emërtojnë stinët e vitit.➤ Të njohin/ emërtojnë muajt e vitit.➤ Regjimi ditor (veprimet që bëhen në mëngjes, në drekë, në darkë).➤ Të tregojë 1-2 veprime që realizon në (mëngjes, drekë, darkë) verbalisht.➤ Të tregojë 1-2 veprime që realizon në (mëngjes, drekë, darkë) duke parë figurën. |
|--|---|

- Të dallojë në kohë (tani, pastaj) veprimtari konkrete.
 - Të dallojë ditë -natë (çfarë shikojmë ditën në qiell, po natën,)
 - Të përmendë aktivitete që kryhen në mëngjes, drekë, darkë.
 - Të dallojë ditët e javës sipas një kalendari javor të formuar.
 - Të dallojë stinët sipas karakteristikave të tyre.
 - Të dallojë muajt e vitit sipas një kalendari të festave mujore .
- Ora - si objekt.
 - Pjesët e orës
 - Lidhja e aktiviteteve konstante me orën kur kryhen p.sh “drekë – ora 12.30”.
 - Leximi i orës së plotë, gjysmë, çerek etj.
- Të dallojë orën si objekt e pjesët e saj.
 - Të orientohet me orën për disa aktivitete si ardhja në shkollë, etj.
 - Të dallojë orën e plotë, gjysmë, etj.

D - Format gjeometrike

Format gjeometrike si rrethor, katror, trekëndor.

- Grupimi sipas formës.
 - Formimi i bashkësisë sipas formës(objekte konkretisht).
 - Formimi i bashkësisë sipas formës me figura (p.sh qarko rrethorët).
 - Rreshtimi konkret sipas formës (petëza).
 - Renditja sipas formës.
 - Emërtimi i formave.
 - Vizatimi me shabllon i formës së dhënë .
 - Vizatimi mbi model (vijë e pandërprerë)
- Vizatimi i formës me bashkim pikash
 - Vizatimi i formës (trekëndësh, katërkëndësh, rrethor)
 - Dallimi i formave në mjedisin e klasës
 - Ndërtimi me petëza i formave të ndryshme si makinë, pallat etj.
 - Trupat gjeometrikë.
- Të tregojë format gjeometrike. (rrethor, trekëndor, katërkëndor).
 - Të grupojë sipas formës.
 - Të operojë me objekte sipas një forme të caktuar.
 - Të rendisë format sipas një kriteri të caktuar nga e majta në të djathtë.
 - Të emërtojë format.
 - Të vizatojë format gjeometrike –me shabllon.
 - Të vizatojë format gjeometrike-mbi model.
 - Të vizatojë format gjeometrike- me bashkim pikash.
 - Të vizatojë format pa model.
 - Të përdorin format gjeometrike për të krijuar figura komplekse.
 - Të dallojnë trupat gjeometrikë si sfera, kubi etj.

Linja: Modelet dhe marrëdhëniet (zhvillimi i shqisave-perceptimi)

Njohuritë

Rezultatet e pritshme

Diskriminimi shqisor

A - Perceptimi vizual (të parit)

- Lokalizim i objektit/ figurës së kërkuar
- Lojë :”Kush mungon? Ku ishte lodra? Gjej vendin ...Kush iku? etj.”
- Lojë “Vendi i ..., Kjo është...(nga një pjesë e lodrës /figurës të gjejë të tërën).
- Lojë “Gjej objektin ndryshe”.
- Grupim sipas një kriterit (ngjyrë, formë, madhësi) – objekte / figura.
- Qarkim sipas një kriterit (ngjyrë, formë, madhësi) objekte / figura.
- Rreshtim sipas një kriterit (ngjyrë, formë, madhësi) objekte / figura.
- Ritëm sipas një kriterit (ngjyrë, formë, madhësi) objekte / figura.
- Koncepti njësoj- ndryshe (ngjyrë, formë, madhësi) etj. .
- Ngjyrosje sipas kodit (simbol- ngjyrë).
- “Figura e fshehur”.
- Lidhja “Figurë - hije”
- Lidhja objekt - figurë.
- Plotëso figurën.
- Të ndjekë me sy objektin që lëviz.
- Të dallojë objektin/ personin e kërkuar në ambient, në grumbull, afër, larg etj.
- Të kërkojë objektin/ personin e fshehur.
- Të dallojë katër ngjyrat bazë (e kuqe, blu, jeshile, e verdhë)- në objekte/ figurë.
- Të dallojë tre format gjeometrike (rrethor, katror, trekëndor).
- Të dallojë madhësitë.
- Të dallojë cilësitë e objekteve apo personave si: forma, ngjyra, madhësia etj.
- Të dallojë objektin/figurën kryesore nga sfondi.
- Të dallojë objektin/ figurën ndryshe.
- Të ngjyrosë sipas kodit (simbol- ngjyrë).
- Të zhvillojë kujtesën vizuale.
- Të gjejë figurën e fshehur midis figurave të tjera.
- Të bëjë lidhjen figurë - hije.
- Të bëjë lidhjen objekt - figurë.
- Të gjejë pjesët munguese të figurës.

B - Perceptimi taktil (të prekurit)

- Aktivitete me materiale të ndryshme (manipulim, modeli, prodhim).
- Lojëra si “Dallo objektin në thes” E kujt është?
- Lojë “Gjej objektet njësoj” me të prekur.
- Lojë “Gjej objektet me majë” duke prekur etj.
- Të manipulojë materiale të ndryshme për të dalluar llojin e tyre.
- Të gjejë nëpërmjet prekjeve objektin.
- Të prekë sipërfaqe me teksture të ndryshme si e lëmuar, e ashpër, e njomë, etj.
- Të manipulojë materiale me përbërje të ndryshme si vajore, brumë, plastelinë etj.
- Të dallojë objekte sipas një cilësie:(i butë-i fortë, i ftohtë – i ngrohtë, i madh – i vogël, forma etj.)

C - Perceptimi auditive (të dëgjuarit)

- Reagim kur i thirret emri i vet.
- Reagim i nxënësit ndaj ndryshimeve të intonacionit të zërit në klasë.
- Të zhvillojë kujtesën taktile.
- Të ketë reagime ndaj zhurmave, zërave të ndryshëm.

- Njohja e zërit të shokut, shokëve.
 - Njohja e zërit të mësuesit
 - Dallimi i kafshëve/ objekteve të ndryshme si makina, era etj. duke dëgjuar tingujt e tyre me mjete didaktike/ imitim.
 - Lojëra të tipit “Kush foli? Kush iku? etj.”
 - Dallimi i intonacionit i ulët-i lartë (veprimtari praktike).
 - Riprodhim/ imitim tingujsh, zhurmash, rrokjesh e fjalësh.
 - Vjersha .
 - Histori me muzikë.
 - Ushtrime sipas melodisë.
 - Dëgjim këngësh, shoqërim me gjeste, zëra e lëvizje ritmike.
- Të lidhë zhurmën me objektin.
 - Të reagojë sipas intonacionit të zërit.
 - Të dallojë llojet e zërave.
 - Të zhvillojë kujtesën auditive.

D - Perceptimi (të shijuarit)

- Dallimi ushqime të kripura- të tharta.
 - Dallimi ushqime të hidhura- të ëmbla.
 - Dallimi ushqime pikante.
 - Ushqime që hahen dhe jo.
- Të sensibilizohet (zgjohej) shqisa e të shijuarit.
 - Të dallojë shije të ndryshme.
 - Të dallojë gjërat e ngrënshme nga ato jo të ngrënshme.

E - Perceptimi: Të nuhaturit

- Dallimi aromë e mirë- aromë e keqe.
 - Dallimi i aromave p.sh. i lules, parfumit, sallamit, kekut etj.
- Të sensibilizohet (zgjohej) shqisa e të nuhaturit.
 - Të operohet konkretisht me të.

F - Marrëdhëniet

- Shkak- pasojë- zgjidhje situatash praktike.
 - Absurditete.
- Të realizojë lidhje logjike midis shkakut e pasojës në situata praktike.
 - Të dallojë situatat pa kuptim.

Linja: Matjet (të kundërtat dhe krahasimi)

Njohuritë Konceptet që do të trajtohen	Rezultatet e pritshme
<i>Të kundërtat</i> - Natë- ditë - I ftohtë- i ngrohtë - I rëndë- i lehtë - Shpejt- ngadalë - Njëlloj- ndryshe - shumë- pak- s'ka - I ri – i vjetër - I bukur- i shëmtuar - I dobët – i shëndoshë - Hap - mbyll - I pastër- i pisët - Fillo- ndal etj. ▪ Grupim objekteve /figurash : i madh- i vogël. ▪ Qarkimi objekteve /figurash, i madh - i vogël. ▪ Rreshtimi i objekteve/ figurave, i madh – i vogël. ▪ Klasifikimi i objekteve/ figurave i madh- i vogël. ▪ Shoqërimi një për një sipas madhësisë i objekteve/ figurave . ▪ Rrëzim $1/1$, $1/2$, $2/3$ etj. sipas madhësisë. ▪ Vizatimi i figurave sipas madhësisë (p.sh. rreth i madh, i vogël). ▪ Përdorimi: i madh - i vogël në situatë praktike.	➤ Të krahasojë objektet duke përdorur karakteristika të matshme (i madh-i vogël, i gjatë – i shkurtër, i rëndë, i lehtë, shumë-pak). ➤ Të vendosë objekte në seri sipas një kriteri (ngjyrë, madhësi, formë, sasi etj.).
<i>Sqarim: Në të njëjtën mënyrë trajtojmë çdo koncept.</i> ▪ Vizorja si mjet matës. ▪ Ora matësi i kohës. ▪ Vizatimi me vizore i segmentit i gjatë, i shkurtër.	➤ Të operojë me mënyra praktike matjeje. ➤ Të njohin orën si mjet matës i kohës ➤ Të përdorë vizoren, metrin.

- Njohja me llojet e monedhave/ kartëmonedhave.
- Njohja me vlerën e monedhave/ kartëmonedhave.
- Veprimtari praktike : Në dyqan etj.
- Të njohë / operojë me monedhat, lekët.
- Të operojë me monedhat/ kartëmonedhat për të kryer blerje.

Linja: Numri dhe veprimet

Njohuritë	Rezultatet e pritshme
Numrat 1- 10.	
▪ Identifikimi i numrave në tabelë, fishe. ▪ Identifikimi i numrave në kompjuter. ▪ Identifikimi i numrave në libra. ▪ Identifikimi i numrave në makinë llogaritëse. ▪ Identifikimi i numrave në telefon. ▪ Vjersha me numërime. ▪ Përdorimi i gishtave për numërim. ▪ Imitimi i numërimit deri 10 e më shumë. ▪ Rreshtimi i objekteve, figurave. ▪ Numërimi i objekteve/fig. deri në 3, 5, 10 në rresht. ▪ Numërimi i objekteve/ fig. deri në 3, 5, 10 të vendosura në mënyrë të çrregullt. Numërimi rreshtor (1- 10) në rend ngjitës dhe zbritës(veprimtari praktike). ▪ Krahasimi i numrave(>, <). ▪ Vendosja e numrave në boshtin numerik deri në 10. ▪ Krahasimi i numrave në boshtin numerik(para-pas) ▪ Numrat çift- tek. ▪ Numrat deri 100 e më tej me dhjetëshe, qindëshe të plota.	➤ Të dallojë numrat si figurë. ➤ Të tregojë interes për numërimin. ➤ Të numëroje mekanikisht nga 1-10 ose më shumë ➤ Të numëroje objektet me kuptim. ➤ Të numëroje në rendin rritës/zbritës 1—10 ➤ Të dallojë me sy sasi të:” shumë –pak-- s’ka ”. ➤ Të lidhë/operojë “bashkësi- etiketë”. ➤ Të dallojë bashkësinë me zero element. ➤ Të lidhë numrin me sasinë që përfaqëson. ➤ Të dallojë bashkësinë me një/ shumë element. ➤ Të përdorë shoqërimin një për një për të numëruar, krahasuar sasi të (më shumë, më pak, aq sa....)
Sasia	
▪ Grupimi i objekteve/ fig: Shumë –pak. ▪ Qarkimi i objekteve: Shumë –pak ▪ Qarkimi i figurave: Shumë –pak ▪ Vizatimi i figurave: Shumë –pak. ▪ Shoqërimi një për një me objekte.	➤ Të identifikojë numrat/sasi të në situata të jetës reale. ➤ Të përdorë numrat rreshtorë (i pari , i dytii fundit)

- Shoqërimi një për një me figura.
 - Lidhja: sasi – numër.
 - Kapja me sy (pa numëruar) e sasisë deri në 5.
 - Bashkësia me zero element.
 - Bashkësia me një element.
 - Lidhja: bashkësi- etiketë me fig.
 - Lidhja: sasi – numër.
 - Krahasoni i sasisë: shumë – pak - 1;
 - 0 – 10 objekte/figura.
 - Shoqërimi një për një i sasive 0 – 10.
- Të shkruajë grafikun e numrave 1---10(mbi model, me model, me diktim)
 - Të vendosë numrat në boshtin numerik (nga 1—10)
 - Të kryejë mbledhjet e numrave me objekte/ figura (deri në 10 e më shumë)

Veprimet (+, -, .)

- **Mbledhja me 1** me objekte/ figure apo situatë konkrete.
 - **Simbole** të ndryshme midis tyre dhe ai i mbledhjes(+), i barazimit (=).
 - Simboli më i vogël (<Simboli më i madh(>)
 - Mbledhja e numrave deri në 5/10 e më shumë me 1, 2, 5, 10 etj.
 - Mbledhja me dhjetëshe të plota deri 100.
 - Ushtrime me plotësim 10/ 100 p.sh:

$$7 + \dots = 10$$

$$70 + \dots = 100$$
 - Mbledhja e dhjetësheve me njëshe pa kalim dhjetë p.sh:

$$10 + 3 = \dots$$

$$30 + 5 = \dots$$
 - Mbledhja me kalim dhjetë deri 20, 100 etj.:

$$7 + 4 =$$

$$17 + 4 =$$
- Të dallojë simbolet matematikore (+), (-), (=), (<), (>)
 - Të kryejë mbledhjet e numrave (deri në 10 e më shumë) në kolonë.
 - Të kryejë zbritjen e numrave me objekte/ figura (deri në 10 e më shumë).

- Mbledhje në kolonë pa kalim dhjete.
- Mbledhja me kalim dhjete.

➤ Të kryejë zbritjen e numrave (deri në 10 e më shumë)

- Problema me një/ dy veprime.
- Simboli i zbritjes (-)

➤ Të krahasojë numrat.

- Zbritja e numrave brenda dhjetëshes
- Zbritje me dhjetëshe të plota deri 100.
- Ushtrime me plotësim brenda 10/ 100 p.sh:

➤ Të zgjidhë situata problemore.

$$7 - \dots = 5$$

$$70 - \dots = 30$$

- Zbritja me njëshe pa kalim dhjetë p.sh:

$$13 - 3 = \dots$$

$$30 - 20 = \dots$$

- Zbritja me kalim dhjetë deri 20, 100 etj.:

$$17 - 8 =$$

$$21 - 14 =$$

- Zbritje në kolonë pa kalim dhjetë.
- Zbritja në kolonë me kalim dhjetë.

- Problema me një/ dy veprime.

Njohuritë

Rezultatet e pritshme

A- Të kundërtat - krahasimi

- Djalë - vajzë,
- Natë - ditë,
- I ftohtë - i ngrohtë,
- I rëndë - i lehtë,
- Shpejt - ngadalë
- Njësoj - ndryshe,
- Shumë – pak - s'ka
- I ri – i vjetër
- I bukur - i shëmtuar
- I dobët – i shëndoshë.
- I pastër i pisët
- Hap - mbyll,
- Simetria
- Shkak – pasojë - zgjidhje situatash praktike.

- Të njohë dhe operojë me konceptet e kundërta me mjete si dhe në jetën e aktivitetet e përditshme.

- Grupim objekteve /figurash: i madh- i vogël.
- Qarkimi objekteve/figurash, i madh - i vogël.
- Rreshtimi i objekteve/figurave, i madh – i vogël.
- Klasifikimi i objekteve/ figurave i madh - i vogël.
- Shoqërimi një për një sipas madhësisë i objekteve/figurave.
- Rritëm $1/1$, $1/2$, $2/3$ etj. sipas madhësisë.
- Vizatimi i figurave sipas madhësisë (p.sh. rreth i madh, i vogël).
- Përdorimi: i madh - i vogël në situatë praktike.

- Të dallojë konceptet i madh - i vogël.

- Të krahasojë objektet duke përdorur karakteristika të matshme (i madh-i vogël, i gjatë – i shkurtër, i rëndë, i lehtë, shumë - pak).

- Të vendosë objekte në seri sipas një kriteri (p.sh. i madh - i vogël etj.).

Sqarim: Në të njëjtën mënyrë trajtojmë çdo koncept.

B- Matjet

- Matje me mjete rrethore.
- Vizorja si mjet matës.

- Të operojë me mënyra praktike matjeje si me pëllëmbë, me gisht, me libër etj.

- Matja me vizore, metër.
 - Përdorimi i vizores.
 - Ora matësi i kohës.
 - Monedhat.
 - Njohja me vlerën e monedhës.
 - Veprimtari praktike: Në dyqan etj.
- Të njohë mjetet matëse si vizoren, metrin.
 - Të përdorë vizoren, metrin për të matur.
 - Të përdorë vizoren për të vizatuar.
 - Të njohë orën si matës i kohës.
 - Të njohë / operojë me monedhat, lekët.

Tema	Rezultatet e pritshme	I pamundur	I paarritur	Me ndihmë fizike dhe verbale	Me ndihmë verbale		Pa ndihmë	
					Pa saktësi	Me saktësi	Pa saktësi	Me saktësi

IV. BASHKËPUNIMI MES MËSUESVE TË ARSIMIT TË PËRGJITHSHËM DHE ATYRE TË PEDAGOGJISË SPECIALE

Tradicionalisht, në arsimin parauniversitar, mësuesit kanë punuar në klasë vetëm, të izoluar, pra një mësues për një klasë. Ndërkohë që sot fëmijët me aftësi të kufizuara mësojnë në shkollat publike të zakonshme, vetëm para jo më shumë se 20 vitesh, ata mësonin në shkollat speciale dhe në klasa të veçanta, me mësuesit e tyre të arsimit special. Gjatë 20 viteve të fundit, këta nxënës kanë kaluar ngadalë në rrjedhën e shkollave të zakonshme dhe në klasat e tyre. Sot qasja është përfshirja e të gjithë nxënësve në të njëjtën klasë, gjë që ka sjellë funksionimin si ekip të mësuesve të arsimit të përgjithshëm dhe atyre të pedagogjisë speciale, që bashkëpunojnë për të kombinuar njohuritë, perspektivat dhe aftësitë e tyre profesionale.

Ndryshimi më i madh për mësuesit është përcaktimi qartë i rolit të secilit prej tyre: të ndajnë qëllimet, vendimet, udhëzimet në klasë, përgjegjësinë për nxënësit, vlerësimin e të nxënësit të nxënësve, zgjidhjen e problemeve dhe menaxhimin e klasës. Mësuesit duhet të fillojnë ta mendojnë atë si klasën "e tyre". Në vazhdim përshkruhen disa nga aspektet e këtij bashkëpunimi të ri mes mësuesve të arsimit të përgjithshëm dhe atij special.

Çfarë është mësimdhënia bashkëpunuese?

Mësimdhënia bashkëpunuese u përshkrua në fund të viteve 1980 si "një qasje edukative në të cilën mësuesit e përgjithshëm dhe mësuesit e arsimit special punojnë në mënyrë bashkëpunuese dhe të koordinuar për të mësuar së bashku grupet heterogjene të nxënësve në mjedise të integruara arsimore...Në mësimdhënien bashkëpunuese, si edukatorët e përgjithshëm ashtu edhe ata të pedagogjisë speciale janë njëkohësisht të pranishëm në klasë, duke mbajtur përgjegjësi të përbashkëta për mësimin që do të ndodhë brenda atij mjedisi" (Bauëens, Hourcade, & Friend, 1989, f. 36).

Tipari dallues i mësimdhënies bashkëpunuese, është bashkëpunimi i drejtpërdrejtë i mësuesve të arsimit të përgjithshëm dhe të arsimit special që punojnë së bashku në të njëjtën klasë shumicën e ditës mësimore.

Një ekip efektiv mësuesish punojnë së bashku si partnerë të barabartë në marrëdhëniet ndërvepruese, të dy të përfshirë në të gjitha aspektet e planifikimit, mësimdhënies dhe vlerësimit. Fushat për këtë

bashkëpunim përfshijnë kurrikulat dhe mësimdhënien, vlerësimin, si dhe menaxhimin dhe sjelljen në klasë. Siç është vënë re, “çelësi për të bërë punën e bashkë-mësimdhënies është planifikimi i përbashkët. Të dy mësuesit duhet të njohin mirë të gjithë kurrikulën në mënyrë që të mund të ecin “përpara dhe prapa” dhe të mbështesin përpjekjet e njëri-tjetrit. Nëse nuk e njohin kurrikulën, ato nuk janë një bashkë-mësues, janë thjesht një asistent” (Crutchfield, M.).

Në zhvillimin dhe zbatimin e mësimdhënies bashkëpunuese, mësuesit e një shkolle përjetojnë ndryshime të mëdha në mënyrën se si e kryejnë punën e tyre të përditshme. Për të kapërcyer frikën dhe streset e pashmangshme që lidhen me ndryshimin, mësuesit e përfshirë duhet të ndjejnë se janë përgjegjës për ndryshimin dhe se suksesi ose dështimi lidhet drejtpërdrejt me ta.

Çfarë roli luan secili mësues?

Në një model bashkëpunues, mësuesit e arsimit të zakonshëm dhe të arsimit special sjellin secili aftësitë, ekspertizën dhe perspektivat e tyre në ekip. Burimet kombinohen për të forcuar mundësitë, metodat dhe efektivitetin e mësimdhënies dhe të nxënit. Një aspekt i rëndësishëm që zhvillohet nga kjo marrëdhënie është ai që ka të bëjë me faktin se të dy mësuesit kanë ekspertizë në shumë fusha dhe kombinimi i këtyre aftësive i bën të dy mësuesit më efektivë në përmbushjen e nevojave të të gjithë nxënësve.

Përgjegjësia kryesore e mësuesve të klasave të zakonshme është të përdorin aftësitë e tyre për t'i udhëzuar nxënësit sipas kurrikulave zyrtare të arsimit parauniversitar. Ndërsa, përgjegjësia kryesore e mësuesve të arsimit special është të ofrojnë udhëzime duke përshtatur dhe zhvilluar materiale që të përputhen me stilet e të nxënit, pikat e forta dhe nevojat e veçanta të secilit prej nxënësve të tyre. Në kushtet e arsimit special, nevojat individuale të nxënësve shpesh diktojnë kurrikulën.

Mësuesit e zakonshëm zhvillojnë specializimin e përmbajtjes, mësuesit e arsimit special kryejnë specializimin e vlerësimit dhe përshtatjes. Të dy shkëmbejnë trajnim dhe përvojë në lidhje me teknikat e mësimdhënies dhe proceset e të nxënit. Qëllimi i bashkëpunimit të tyre është që të gjithë nxënësve në klasën e tyre t'u sigurohen detyra të përshtatshme që kryhen në klasë dhe në shtëpi, në mënyrë që secili të mësojë, të sfidohet dhe të marrë pjesë në veprimtaritë mësimore.

Planifikimi për bashkëpunim efektiv

Bashkëpunimi përfshin angazhim nga mësuesit që do të punojnë së bashku, nga drejtuesit e shkollave të tyre, nga sistemi shkollor dhe nga komuniteti. Bashkëpunimi përfshin kohë, mbështetje, burime, monitorim dhe, mbi të gjitha, këmbëngulje. Megjithatë, çështja më e madhe është koha - koha për



planifikim, koha për zhvillim dhe koha për vlerësim. Planifikimi duhet të bëhet në nivel lokal (ZVAP-je), në nivel institucioni arsimor si dhe në nivel klase.

Planifikimi në nivel lokal (ZVAP-je) ndihmon për të siguruar që të gjitha burimet do të jenë të disponueshme, duke përfshirë kohën dhe ndihmën profesionale. Planifikimi në nivel shkolle do t'i ndihmojë mësuesit të sigurohen se është dhënë mbështetja e duhur për të mbështetur iniciativat e reja. Drejtorët luajnë një rol udhëheqës jashtëzakonisht të rëndësishëm në lehtësimin e përpjekjeve bashkëpunuese të personelit mësimdhënës.

Planifikimi si në nivel lokal ashtu edhe në nivel shkolle duhet të ofrojë mundësi të zhvillimit profesional të stafit mësimor dhe drejtuesve përmes pjesëmarrjes në seminare, trajnime dhe/ose konferenca profesionale mbi mësimdhënien bashkëpunuese. Motivimi është një përbërës i rëndësishëm për suksesin.

Planifikimi është gjithashtu një faktor në përzgjedhjen e nxënësve që do të jenë pjesë e procesit të bashkëpunimit. Është e rëndësishme të ruhet raporti i duhur i nxënësve të klasës, nxënësve të identifikuar si në rrezik si dhe nxënësve që janë konstatuar se kanë aftësi të kufizuara. Formimi i një klase të tillë është më e lehtë të realizohet në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët sesa në arsimin e mesëm të lartë, ku bëhet grupimi bazuar në zgjedhjen e lëndëve.

Një faktor i rëndësishëm është organizimi i kohës së planifikimit të përbashkët për të dy mësuesit. Sipas studimeve, bashkë-planifikimi duhet të bëhet për çdo periudhë, por njëkohësisht të jetë fleksibël për t'u përshtatur dhe ndryshuar edhe brenda periudhës. Planifikimi duhet të jetë në rishikim të vazhdueshëm për t'i lejuar mësuesit të rishikojnë progresin, të bëjnë rregullime, të vlerësojnë nxënësit dhe të zhvillojnë strategji për të adresuar problemet në lëndë ose për të nxënësit.

Ekspertë të fushës kanë identifikuar pesë tema të planifikimit duke i konsideruar bashkëmësuesit si bashkëplanifikues efektivë:

- Besimi në aftësitë e partnerit.
- Projektimi i mjediseve mësimore si për mësuesit ashtu edhe për nxënësit, i cili kërkon përfshirje aktive.
- Krijimi i mjediseve mësimdhënëse dhe të nxënësit në të cilat vlerësohen kontributet e secilit person.
- Zhvillimi i rutinave efektive për të lehtësuar planifikimin e thelluar, dhe
- Rritja e produktivitetit, krijimtarsisë dhe bashkëpunimit.



Formimi i mësuesve dhe zhvillimi profesional

Bashkëpunimi duhet të jetë pjesë e programeve të përgatitjes fillestare të mësuesve. Kjo ndihmon për të kuptuar që në fillim të karrierës se të gjithë mësuesit do të duhet të punojnë me të gjithë nxënësit, përfshirë nxënësit me nevoja të veçanta. Çdo mësues duhet të studiojë teknikat e mësimit, fushën(t) lëndore, aftësinë e kufizuar, individualizimin, përshtatjen dhe aftësitë për bashkëpunim në klasë.

Koha e shpenzuar për takimet e rrjetit profesional, konsultime, trajnime dhe konferenca profesionale është jetike për suksesin e çdo programi. Mësuesit, ofruesit e shërbimeve përkatëse dhe drejtuesit do të përfitojnë nga mësimit bashkëpunuese.

Si përfundim, gjetjet nga hulumtimet e bëra në shkolla ku praktikohet mësimit bashkëpunuese tregojnë përfitimet e nxënësve si për ata të arsimit special, ashtu edhe për bashkëmoshatarët e tjerë. Nxënësit me arritje të ulëta tregojnë përmirësime në aftësi akademike dhe sociale.

V. MODELE VEPRIMTARISH MËSIMORE NË LËNDË TË NDRYSHME


Planifikimi i orës së mësimit

Emri i fëmijës: Nxënësi	Lëndët: Matematikë	Klasa: III	Koha: 45'	Data: 14.02.2023
Fushat: A) Fusha e komunikimit dhe të shprehurit. ☒ B) Fusha konjitive, ☒ C) Fusha sociale, qytetare, ndërveprimi, relacionet. ☒ D) Fusha motorike (përgjithshme & fine). ☐ E) Fusha e pavarësisë ☒				
Rezultatet e të nxënit: -Krahason dy numra, grupe sendesh duke përdorur shprehjet “më shumë”, “më pak”, “aq sa” - përdor boshtin numerik për të gjetur një numër ndërmjet dy numra të dhëna deri në 20. -rendit numrat njëshifror dhe dyshifror në rendin rritës dhe zbritës.		Fjalët kyçe: E barabartë, aq sa, më e madhe, më e vogël. Çifto, krahaso, shto, mbledh, shuma, përfundimi.		
Metodologjia: Të mësuarit më bazë projekti krahaso, vëzhgo, çifto,		Vendi ku zhvillohet mësimi: Klasa ☒ Klasa burimore ☐		
Burimet dhe mjete didaktike Mjete të riciklueshme, bosht numerik, petëza, trupa gjeometrike.		Lidhja me lëndët e tjera (ndërkurikulare) Gjuhë, Dituri		
Organizimi i aktiviteteve gjatë orës mësimore				
Fusha e komunikimit (Gjuhë) Aktiviteti: Leximi i kërkesave në lëndën e matematikës. Të kuptuarit e kërkesave që lexon. YYYY do të lexojë disa herë kërkesat e ushtrimeve që do të zhvillojë në lëndën e matematikës. Do të shkruajë me shkrim në formë diktimi fjalë dhe kërkesa të shkurtra.		Fusha konjitive (Matematikë) Aktiviteti: Krahasoni i sasisë të elementëve për të njohur dhe kuptuar konceptet aq sa, më shumë, më pak. Nxënësi..... do të zhvillojë veprimtari me mjete të riciklueshme për të krahasuar bashkësi të ndryshme duke përdorur me komunikim verbal marrëdhënien ndërmjet dy bashkësive. Do të zhvillojë veprimtari në boshtin numerik për të kuptuar marrëdhënien ndërmjet numrave, para		

	mbrapa si dhe vendosjen e numrave në rend rritës dhe zbritës.
Fusha motorike (Ed. Fizik) Aktiviteti: Nxënësi..... zhvillon aktivitetet motore konform programit mësimor të klasës që frekuenton.	Fusha sociale (Qytetari, Art pamor) Aktiviteti: Kërkoi shoqes së bankës 3 lapsa më pak se kutia e ngjyrave që mban në portofol. Jepi shokut të bankës 4 fleta me ngjyra me shumë se ai ka në portofol.
Fusha e pavarësisë Aktiviteti: Merr 2 shkumësa më shumë se shoku i bankës. Shpërnda në klasë aq fletore sa fëmijë ka klasa. Nxënësi..... do të zhvillojë veprimtari praktike në klasë gjatë orarit mësimor edhe në lëndët e tjera për të kuptuar më saktë konceptet e marra në lëndën e matematikës.	Vlerësimi: Nxënësi..... do të vlerësohet për njohjen e koncepteve aq sa, më shumë, më pak. Do të vlerësohet për të kuptuarit e kërkesave që lexon në lëndën e matematikës. Do të vlerësohet për orientimin në boshtin numerik Kjo rubrikë do të plotësohet në fund të ditës së mësimi.
Detyrat dhe puna e pavarur: Vazhdimi i përdorimit të të koncepteve më shumë, më pak, aq sa në rutinën ditore, në kuzhinë më mamanë gjatë gatimit dhe shtrimit të tavolinës. (Komunikimi me prindin për të kryer detyrat në shtëpi në funksion praktik)	

Planifikimi i orës së mësimi

Emri i fëmijës: Nxënësi.....	Lëndët: Matematikë	Klasa: V	Koha: 45'	Data: 14.02.2024
Fushat: A) Fusha e komunikimit dhe të shprehurit. ☐ B) Fusha konjitive, ☐ C) Fusha sociale, qytetare, ndërveprimi, relacionet. ☐ D) Fusha motorike (përgjithshme & fine). ☐ E) Fusha e pavarësisë ☐				
Rezultatet e të nxëniti: -Njeh saktë dhe emërton me komunikim joverbal frutat dhe perimet në 80% të rasteve të kërkuara. -Identifikon me komunikim joverbal PO dhe JO për objektet që njeh më saktë. - Zhvillon aftësitë vizuale nëpërmjet aftësimi të motorikës fine. - Njeh dhe shpreh emocionet e veta.		Fjalët kyce: Trego me gisht, prek, bëj si unë, identifikoj, shqiptoj PO, JO, Fruta, perime,		
Metodologjia: Vëzhgo, gjej, cifo, identifikoj me gisht,		Vendi ku zhvillohet mësimi: Klasa ☐ Klasa burimore ☐		
Burimet dhe mjete didaktike Mjete të ricikluar, Figura me fruta dhe perime, tabela e po dhe jo me figura të piktogramave, lojë memorije etj.		Lidhja me lëndët e tjera (ndërkurikulare) Anglisht, Dituri,		
Organizimi i aktiviteteve gjatë orëve mësimore				
Fusha e komunikimit (Gjuhë) Aktiviteti: Identifikimi me gisht i frutave dhe perimeve Nxënësi...do të identifikojë me gisht frutat dhe perimet pa ndihmë dhe pa nxitje. Do të identifikojë figurat në pozicione të ndryshme duke u përgjigjur saktë në 80% të rasteve të kërkuara.		Fusha konjitive (Matematikë) Aktiviteti: Kuptimi i PO dhe JO Nxënësi.... do të zhvillojë një aktivitet për të identifikuar PO dhe Jo në tabelën e piktogramave nëpërmjet komunikimit joverbal (gishtit). Do të tregohet kujdes që XXX të mos vendosë gishtin pa iu drejtuar pyetja. Nxënësi.... do të identifikojë PO dhe JO për objektet që pëlqen më shumë dhe ato që nuk pëlqen.		

	 
Fusha e pavarësisë Aktiviteti: Përdorimi i PO dhe Jo në rutinën ditore	Vlerësimi: Nxënësi..... do të vlerësohet për njohjen e PO dhe JO në sa përqind të rasteve të kërkuara u përgjigj saktë, Sa fruta dhe perime arrin të identifikojë pa ndihmë e pa nxitje. Kjo rubrikë do të plotësohet në fund të ditës së mësimit.
Detyrat dhe puna e pavarur: Vazhdimi i përdorimit të PO dhe Jo në shtëpi si dhe angazhimi në kuzhinë për të larë frutat dhe perimet. (Komunikimi me prindin për të kryer detyrat në shtëpi në funksion praktik)	

Planifikimi i orës së mësimit

Emri i fëmijës: Nxënësi.....	Lëndët: Gjuhë	Klasa: VIII	Koha: 45'	Data: 4.3.24
Fushat: A) Fusha e komunikimit dhe të shprehurit. ☒ B) Fusha konjitive, ☐ C) Fusha sociale, qytetare, ndërveprimi, relacionet. ☐ D) Fusha motorike (përgjithshme & fine). ☐ E) Fusha e pavarësisë ☐				
Rezultatet e të nxënit: Dallon nocionet bazë të kohës kronologjike (e shkuar, e tashme, e ardhme) Vendos në raport të rregullt foljen me treguesit kohor të tipit dje, sot, nesër.		Fjalët kyce: Dje, sot, nesër, më parë, tani, pastaj, e shkuar, e tashme, e ardhme		
Metodologjia:		Vendi ku zhvillohet mësimi: Klasa ☒ Klasa burimore ☐		
Burimet dhe mjete didaktike Figura të PECS, kalendar, kartolina të vjetra, foto të sotme, të dhëna meteorologjike.		Lidhja me lëndët e tjera (ndërkurikulare) Fizikë, Biologji,		
Organizimi i aktiviteteve gjatë orëve mësimore				
Fusha e komunikimit (Gjuhë) Aktiviteti: E shkuara, e tashmja, e ardhmja Për organizimin e kësaj ore do të përdoret tabela e mëposhtme: Do të marrim fotot e mbledhura për këtë orë mësimi duke i klasifikuar në tabelën e mësipërme. Fotot do të		Fusha konjitive (Matematikë) Aktiviteti:		

jenë të aktiviteteve të zhvilluara në klasë. Do të vendosim fotot sipas kronologjisë së zhvilluar. Fotot që kemi bërë dje do ta vendosim tek pjesa e boshtit ku është shkruar e shkuar. Cfarë bëjmë tani tek e tashmja dhe aktivitete që do të zhvillojmë më vonë tek e ardhmja. Gjithashtu do të përfshijmë edhe kalendarin me ditët e javes si dhe orarin e mësimeve. Ora që do të zhvillojmë do të jetë orën e tretë, Ora e parë dhe e dytë do të vendosen e shkuar, ora e trete tek e tashmja dhe ora e katërt dhe e pestë tek e ardhmja. Gjithashtu do të përfshijmë edhe kalendarin e motit që mbajmë shënim në klasë. Së bashku me fëmijën do të bëjmë klasifikimin e kohës me shi dhe me diell, ditët që kemi kaluar, sot dhe si do të jetë moti në ditët në vazhdim. Gjithë kjo veprimtari do të zhvillohet për të bërë më të qartë konceptin e klasifikimit të kohë (veprimit; më parë, tani, pastaj) Do të ushtrohemi në përsëritjen e zgjedhimit të foljeve në kohën e tashme. Do të njihet fëmijë me kohën e shkuar (të pakryer) dhe të ardhme. Do të shënojmë mbaresat me ngjyrë ndryshe nga rrënja e fjalës.	
Fusha motorike (Ed. Fizik) Aktiviteti:	Fusha sociale (Qytetari, Art pamor) Aktiviteti:
Fusha e pavarësisë Aktiviteti: Përshkrimi i historisë me sekuenca që do të zhvillohen në orën e gjuhës shqipe, më parë, tani dhe më pas.	Vlerësimi: Nxënësi..... fillimisht kërkoi ndihmë për të klasifikuar figurat sipas kohës së përshkrimit. Vështirësinë më të madhe e pati tek renditja e sekuecave të historive të cilat nuk i kishte punuar më parë. Kjo rubrikë do të plotësohet në fund të ditës së mësimit.
Detyrat dhe puna e pavarur: Të përshkruajë në familje aktivitetet që zhvilloi në shkollë dhe anasjelltas, të nesërmen në mëngjes do të tregojë në shkollë çfarë ka ngrënë në drekë, darkë dhe në mëngjes në shtëpi.	

Data e zhvillimit: 16.02.2024

Ora: III-IV

Nxënësi: D.D

Klasa I-C

Lënda: Matematikë

Tema e mësimit: *Një më shumë, një më pak. (Orën e parë mund të zhvillohen vetëm veprimtarime objekte kurse orën e dytë vazhdohet me tekstin mësimor).*

Rezultatet e të nxënit të kompetencave sipas temës mësimore:

- Gjen 1 më shumë, 1 më pak senjë numër i dhënë.
- Demonstron besim në forcat vetjake.
- Respekton përpjekjet personale dhe ato në grup.

Fjalët kyçe: 1 më shumë , 1 më pak.

Burimet: *Libri i matematikës, tabela e numrave, kube dhe mjete ndihmëse.*

PËRSHKRIMI I VEPRIMTARISË MËSIMORE

✓ **Ora 1**

□ **Hapi i parë:** *Paraqitni objekte të ndryshme ndihmës si kub, lapsa .*

Drejtohen pyetjet. Sa kub kemi në tavolinë? Nëse heqim 1 kub, sa kub na mbeten? Po nëse shtojmë 1 ose 2, sa do bëhet numri?

□ **Hapi i dytë:** *Përsëritet dhe me objekt të tjera i njëjti ushtrim.*

□ **Hapi i tretë:** *Punë praktik në dysh. Njëri nxënës do të jetë numri 1 dh tjetri do të jetë numri 2. Nxënësi m numrin 1 shkruan një numër dh nxënësi numër 2 gjen numrin që është 1 më shumë s numri i shokut. Përsëritet disa herë, ndërrohen rolet për të gjetur 1 më pak s numri i dhënë .*

Ora 2

□ **Hapi i parë:** *Punë individuale me nxitje. Punon me nxitje për plotësimin e detyrës si duhet në tekst.*

➤ **Hapi i dytë:** *Plotëso, 3,....5.....7.....,.....10*

Plotëso, 9,.....,7.....,5.....,3.....,2.....

□ **Hapi i tretë:** *Punë në grupe. Njëri grup thotë një numër, grupi tjetër tregon numrin pasues. Grupi tjetër tregon numrin dhe grupi tjetër tregon një numër më pak se numri i thënë .*

VLERËSIMI MBI ARRITJEN E NXËNËSIT

Gjetjen e 1 më shumë, 1 më pak, se një numër i dhënë. Përfshirja dhe aktivizimi në grup.

Puna e pavarur,

DETYRË SHTEPIE: Plotëso fletoren e punës. Detyra të veçanta sipas nivelit të nxënësve.

DITAR PËR ZHVILLIMIN E PROCESIT MËSIMOR

Data e zhvillimit: 16.02.2024

Ora: I-II

Nxënësi: D.D

Klasa: I-C

Lënda: Abetare

Tema e mësimit: Shkronja Gj, Ushtrime në fletoren e punës

Rezultatet e të nxënësit të kompetencave sipas temës mësimore:

- Dallon shkronjën Gj.
- Gjen shkronjën Gj në fjalë.
- Shkruan shkronjën Gj e shtypit.
- Plotëson sipas figurës fjalët që mungojnë.
- Shkruan shkronjën Gj plus zanoret.

Fjalët kyçe: Gjethe, Gjarpër, Gjilpërë

Burimet: Libri i Abetares, Etiketa me fjalë të ndryshme, Shkronjat, Grafiku i shkronjës Gj të shtypit

PËRSHKRIMI I VEPRIMTARISË MËSIMORE

✓ Ora 1

- **Hapi i parë:** Paraqesim shkronjën Gj. Cfarë shkronje është? (bashkëtingëllore)
- **Hapi i dytë:** Shqiptohet tingulli Gj. Shihen figurat e lidhura me shkronjën Gj.
- **Hapi i tretë:** Shkruajmë në tabelë shkronjën Gj e madhe e shtypit dhe shpjegojmë hapat që ndiqen për ta shkruar atë.

✓ Ora 2

- **Hapi i parë:** Ndajmë në rrokje fjalët që kanë në përbërje shkronjën Gj.
- **Hapi i dytë:** Shkruajmë në fletore me nxitje grafikun e shkronjës Gj. Shkruajmë në fletore me nxitje disa fjalë që kanë në përbërje shkronjën Gj.
- **Hapi i tretë:** Plotësojmë ushtrimet në fletoren e punës, faqe 43



VLERËSIMI MBI ARRITJEN E NXËNËSIT

Nxënësi identifikon shkronjën Gj. Ndan në rrokje fjalët të cilat kanë shkronjën Gj në përbërjen e tyre, pa ndihmë.

Shkruan me ndihmë grafikun e shkronjës Gj. Plotëson me ndihmë ushtrimet e dhëna.

DETYRË SHTEPIE: *Në fletoren e shtëpisë shkruajmë fjalët Gjethe, Gjarpër, Ngjalë, Gjysh*

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Nxënësi: X. X	Shkalla: 1	Klasa: II -A
Tema mësimore: Shkronja Nj			Situata e të nxënit: Binjaket	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:			Fjalë kyçe: binjaket, Manjola, Njomëza, foshnja, njëshi	
Nxënësi: - Drejtshqipton tingullin Nj. - Identifikon me anë të të parit fjalët që përmbajnë shkronjën Nj në pozicione të ndryshme. - Tregon figurën qendrore. - Formon fjali me fjalët e dhëna.			Metodologjia: - Dëgjim - diskutim - Marrëdhëniet pyetje-përgjigje - Punë individuale	
Burimet e informacionit dhe mjete: Libri i nxënësit, grafiku i shkronjës Nj të shtypit, fisha që përmbajnë shkronjën Nj , kompjuter, video-projektor			Lidhja me lëndë/ fusha të tjera: Matematikë,Arte, Shkencat e natyrës.	
Organizimi i orës së mësimit: Veprimtari paraprake:Nxënësit dëgjojnë këngën për shkronjën Nj nga Youtube. Këngën mund ta gjeni në këtë link: https://youtu.be/jlmmud_S63q. Teksti i këngës: <i>Ejani fëmijë, bashkë ne të këndojmë, shkronjën tonë të re, sot ne po mësojmë! Cila është shkronja e re, që sot do të mësojmë ne? Ajo është shkronja Nj. Nj si njolla, nj-njeriu, nj është shkronja jonë e re! Nj, nj, nj, nj, kjo është shkronja jonë e re! Kjo është shkronja Nj!</i> Hapi 1. Shiko – Diskuto: Paraqitet një foto me binjake dhe nxitet nxënësi të tregojë me gje të rreth saj:-Çfarë shikon? Çfarë di për binjaket? Si duken ato? A duken njësoj ato gjithmonë? Ta shqiptojmë së bashku fjalën. Shkruhet fjala BINJAKET në tabelë dhe nxitet ta lexojë globalisht. Kryhet procesi i analizës për shpërndarjen e tingullit dhe shkronjës Nj. Sa rrokje ka kjo fjalë? Provojmë ta ndajmë: BI-NJA-KET. Pra, fjala BINJAKET ka tri rrokje. Ku ndodhet shkronja Nj? (Shkronja Nj gjendet në me të fjalës. Hapi 2. Marrëdhëniet pyetje-përgjigje: Nxitet nxënësi të shqiptojë tingullin e shkronjës Nj që ndodhet në krye të faqes. Theksohet se është tingulli bashkëtingëllor që është i përbërë nga dy shkronja: N dhe j. Udhëzohet nxënësi të tregojë figurën qendrore, duke emërtuar çdo objekt që shohim. Ndiemohet me pyetjet: Çfarë shikon në figurë? Ku ishin binjaket? A të pëlqejnë veshjet e tyre? Cila stinë është? Nga e kuptoni që është verë? Si mendoni, çfarë kanë blerë ato? Lexojnë fjalinë: <i>Manjola dhe Njomëza janë binjake</i>. Sa fjalë ka kjo fjali? Te emri <i>Manjola</i> sa rrokje janë? Gjenë rrokjet me përplasje të shuplakave. (Tri rrokje.) Ku gjendet shkronja Nj? Përsëritet veprimtaria edhe me emrin <i>Njomëza</i> Hapi 3. Punë individuale: Ush.1: Nxënësi udhëzohet të vendosë rrokjet: <i>nja,një, njo</i> në vendin e duhur. bikët, shqipo, shi, lla.				

bi ____, ____, kët, shqipo ____, ____, ____, ____, shi, ____, ____, lla

Ush.2: Diskutoj me nxënësin fjalët e paraqitura me figura. Lexojmë fjalën e parë: *një ulli, disa ullinj*. - Ku ndodhet shkronja Nj te fjala *ullinj*: në fillim, në mes, apo në fund? (në fund). Po te figura e dytë, çfarë shikoni? *Një ftua, disa ftonj*. Dëgjojeni me kujdes fjalën *ftonj*: Ku e dëgjon tingullin **Nj**? Vazhdohet veprimtaria edhe me fjalët e tjera. Fjalët: *ullinj, ftonj, lumenj, kallinj misri*, cilën shkronjë marrin kur janë më shumë se një? Marrin shkronjën *nj*. Qarko shkronjën *nj* në të gjitha këto fjalë.

Vlerësimi: Nxënësi vlerësohet për:

- shqiptimin e tingullit të shkronjës **NJ**
- identifikimin dhe qarkimin e shkronjës **Nj** në pozicione të ndryshme.
- tregimin e figurës qendrore (binjakët)
- formimin e fjalive me fjalët e dhëna.

Detyrë shtëpie:Formo fjali me fjalët: foshnja, Manjola,lumenj, shkronjat.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi

Lënda: Gjuhë shqipe

Klasa: VIII-të

Tema mësimore: Përralla dhe fabula

Kompetencat:

1. Të dëgjuarit
2. Komunikimi dhe të shprehurit

Situata e të nxënit: Mësuesi mund të përdorë një nga variantet e sugjeruara

- Dhelpra dhe Lejleku dy gosti(Film vizatimor shqiptar 10 minuta 17 sekonda)
- Përrallë për fëmijë-Dhelpra dhe Lejleku (Tregim I përrallës shoqëruar me vizatime)

3 minuta e 20 sekonda

Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.

- dëgjon për një qëllim të caktuar përrallën
- përgjigjet rreth pyetjeve të përmbajtjes
- ritregon përrallën

Fjalë kyç : përrallë, figura.

Burimet: Teksti mësimor, CD (youtube), libra me përralla dhe fabula nga Ezopi, LA Fonteni

Lidhja me fushat e tjera dhe me temat ndërkurrikulare: Biologji, Qytetari, Arte, TIK, Teatër

Metodologjia: diskutim, pyetje-përgjigje, punë e drejtuar

Organizimi I mësimit për realizimin e temës

Hapi parë

Mësuesja lexon përrallën, ose vendos CD me filmin vizatimor

1. Dhelpra dhe Lejleku dy gosti (Film vizatimor shqiptar 10 minuta 17 sekonda). Vendosjen e CD në kompjuter e bën vetë nxënësi. OSE
2. Përrallë për fëmijë “Dhelpra dhe Lejleku” (Tregim i përrallës shoqëruar me vizatime). 3minuta e 20 sekonda.

Se cilën do të përdorë nga variantet e mësipërme e zgjedh mësuesi duke e përshtatur me aftësinë e nxënësit

Hapi dytë

Bisedë: Ndhimojmë më pyetjet bisedën

- Çfarë ndodhi në përrallën, ose film?
- Emërtoi figurat (personazhet) dhelpra dhe lejleku
- Çfarë vështirësie kishte lejleku?
- E përshkruajmë lejlekun. Lejleku është shpend me pendë të bardha, sqep, qafë dhe këmbë të gjata. Po dhelpra çfarë ngjyre e ka trupin? Bishti i saj është i gjatë apo i shkurtër? Dhelpra është dinake.
- Si veproji dhelpra me lejlekun?
- Si u ndie lejleku? Me këtë pyetje nxit mundësinë për të treguar vlerat që mbartin personat me aftësi ndryshe në komunitetin e klasës, shkollës etj.

Hapi tretë

Vizato lejlekun dhe dhelprën sipas rubrikës(😊 ; 😞) ose të shkruaj emrat(sipas aftësisë së nxënësit)

😊 _____

😞 _____

Mesazhi i përrallës që mësuesja do të punojë me nxënësin

Nuk do të lejojmë askënd të na mërzi, duhet të tregojmë mundësitë dhe aftësitë që mbartim.

Reagimet _____

(Në këtë rubrikë shënojmë me kujdes reagimet e nxënësit gjatë dëgjimit të përrallës, ose gjatë shikimit të filmit vizatimor (përqendrimi në minuta)

Cilin personazh vendos tek rubrika 😊 , 😞 etj.

P.S Këtë model ditari ka patur raste që e kam zhvilluar për tre orë mësimore, por ka parur raste edhe në gjashtë orë mësimore me nga 45 minuta. Secili hap kalonte për 45 minuta ose 90 minuta duke qenë se nxënësit kanë zhvillim të ndryshëm por duke përdorur teknologjinë për dëgjimin e përrallës u arrit të realizohen rezultatet e të nxënës pavarësisht nga koha e shfrytëzuar.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi

Lënda: Gjuhë shqipe

Klasa: VIII-të

Tema mësimore: Përralla dhe fabula

Kompetencat:

- Të dëgjuarit
- Komunikimi dhe të shprehurit

Situata e të nxënit: Mësuesi mund të përdori një nga variantet e sugjeruara

- Dhelpra dhe Lejleku dy gosti(Film vizatimor shqiptar 10 minuta 17 sekonda)
- Përrallë për fëmijë-Dhelpra dhe Lejleku (Tregim i përrallës shoqëruar me vizatime)

3 minuta e 20 sekonda

Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.

- dëgjon për një qëllim të caktuar përrallën
- përgjigjet rreth pyetjeve të përmbajtjes
- ritregon përrallën

Fjalë kyç : përrallë, figura.

Burimet: Teksti mësimor, CD (youtube), libra me përralla dhe fabula nga Ezopi, LA Fonteni

Lidhja me fushat e tjera dhe me temat ndërkurrikulare: Biologji, Qytetari, Arte, TIK, Teatër

Metodologjia: diskutim, pyetje-përgjigje, punë e drejtuar

Organizimi i mësimit për realizimin e temës

Hapi parë

Mësuesja lexon përrallën, ose vendos CD me filmin vizatimor

1. Dhelpra dhe Lejleku dy gosti (Film vizatimor shqiptar 10 minuta 17 sekonda). Vendosjen e CD në kompjuter e bën vetë nxënësi. OSE
2. Përrallë për fëmijë “Dhelpra dhe Lejleku” (Tregim i përrallës shoqëruar me vizatime). 3minuta e 20 sekonda.

Se cilën do të përdorë nga variantet e mësipërme e zgjedh mësuesi duke e përshtatur me aftësinë e nxënësit

Hapi dytë

Bisedë: Ndhimojmë më pyetjet bisedën

- Çfarë ndodhi në përrallën, ose film?
- Emërtoi figurat (personazhet) dhelpira dhe lejleku
- Çfarë vështirësie kishte lejleku?
- E përshkruajmë lejlekun. Lejleku është shpend me pendë të bardha, sqep, qafë dhe këmbë të gjata. Po dhelpira çfarë ngjyre e ka trupin? Bishti i saj është i gjatë apo i shkurtër? Dhelpira është dinake.
- Si veproi dhelpira me lejlekun?
- Si u ndie lejleku? Me këtë pyetje nxit mundësinë për të treguar vlerat që mbartin personat me aftësi ndryshe në komunitetin e klasës, shkollës etj.

Hapi tretë

Vizato lejlekun dhe dhelpërën sipas rubrikës(😊 ; 😞) ose të shkruaj emrat(sipas aftësisë së nxënësit)





Mesazhi i përrallës që mësuesja do të punojë me nxënësin

Nuk do të lejojmë askënd të na mërzi, duhet të tregojmë mundësitë dhe aftësitë që mbartim.

Reagimet _____

(Në këtë rubrikë shënojmë me kujdes reagimet e nxënësit gjatë dëgjimit të përrallës, ose gjatë shikimit të filmit vizatimor (përqendrimi në minuta)

Cilin personazh vendos tek rubrika 😊 , 😞 etj.

P.S Këtë model ditari ka patur raste që e kam zhvilluar për tre orë mësimore, por ka parur raste edhe në gjashtë orë mësimore me nga 45 minuta. Secili hap kalonte për 45 minuta ose 90 minuta duke qenë se nxënësit kanë zhvillim të ndryshëm por duke përdorur teknologjinë për dëgjimin e përrallës u arrit të realizohen rezultatet e të nxënës pavarësisht nga koha e shfrytëzuar.

Format plani ditor i mësuesit ndihmës

Për nxënësin që ndiqet me PEI

Data:

Fusha: Gjuhët dhe Komunikimi

Shkalla : I

Klasa : e I-b

Ora : e parë

Emri i nxënësit(kodi): xxxxxxxx

Lënda: Gjuhë shqipe

Tema mësimore: Përralla: “Ariu dhe miu”

Situata e të nxënit: Lojë në role ,maska të personazheve (ariut dhe miut), etiketa me shkronja, fjalë.

Burimet: Libri, fletë pune, etiketa me shkronja ,fjalë, maska të personazheve të përgatitura. Fletë pune të përgatitura me modelimet e shkronjave.

Rezultatet e të nxënit:

- Tregon personazhet e pjesës.
- Bashkëpunon në lojë.
- Plotëson me ndihmë modelimet.
- Shqipton tingujt, shkronjat , fjalët që i kërkohen.
- Merr komandat .
- Përqëndrohet në qëndrat e aktivitetit

Lidhja me fushat e tjera:Arte, matematikën

Metodologjia: Lojë në role,veprimtari leximi, veprimtari shkrimi.punë në grupe,punë në grupe dyshe.

Organizimi i orës së mësimit

Ora mësimore organizohet sipas planifikimit që ka bërë mësuesja e lëndës.(në bashkëpunim)

Veprimtari 1:E orientoj nxënësen për të qënë e përqëndruar në qëndrat e aktivitetit.E ndihmoj të ndjek mësuesen dhe shokët në leximin e pjesës Ariu dhe miu.E orientoj në gjetjen e personazheve në ilustrimet e pjesës në libër. Shqiptojmë fjalët ariu dhe miu , dhe disa fjalë të tjera nga pjesa. Imitojmë personazhet e kafshëve.Shqiptimi i fjalëve dhe imitimi i personazheve bëhen individuale, në grup , dhe në kor.



Veprimtari 2: E ndihmoj dhe e orientoj nxënësen për të marrë pjesë në lojën me maska dhe për të kuptuar rolin që ajo ka. Nxsis nxënësit e tjerë në bashkëpunim me mësuesen e lëndës për ta përfshirë në lojë dhe të bashkëpunojnë me të.

Veprimtari 3: Nëpërmjet shkronjave lëvizore e pyes dhe e orientoj në gjetjen e tyre. E orientoj në plotësimin e modelimeve shkronjat (I, A, U, E, O, Y, E). E orientoj nxënësen në ngjyrosjen e modelimit të personazheve të pjesës. Nxsis shokët dhe shoqet për ta ndihmuar dhe për ta përfshirë në punën në grup.

Ecuria: U përqendrua në qendrat e aktivitetit, tregoi personazhet e pjesës me orientim, bashkëpunoi në lojë, shqiptoi shkronjat dhe fjalët që ju kërkuan, plotësoi me ndihmë detyrat dhe ngjyrosi modelimet.

Vlerësimi: Vlerësohet me stimuj të ndryshëm për përqendrimin, bashkëpunimin në grup dhe në lojë, në marrjen e komandave, në plotësimin e detyrave të modeluara. E vlerësoj me stimuj dhe stikera në detyrat e klasës dhe detyrat e shtëpisë. (detyra e modeluar, punimet e nxënësës reklamohen në këndin e klasës bashkë me detyrat e nxënësve të tjerë të klasës).

Detyrë shtëpie: E orientoj në detyrat e shtëpisë, në bashkëpunim me mësuesen e lëndës kemi përgatitur detyrat : modelimet e shkronjave a, i, u, e, o, y, ë, (zanoret) ngjyrosjen e grafikut të tyre.

(Rubrikat : ecuria, vlerësimi, detyrë shtëpie plotësohen në fund të orës mësimore)



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Rruga "Naim Frashëri"

Nr. 37

Tiranë

Shqipëri

www.ascap.edu.al

sekretaria@ascap.edu.al

